

MËSOJ LUTJET E MIA



M Ë S O J LUTJET E MIA







MËSOJ LUTJET E MIA

KRYESIA E ÇËSHTJEVE FETARE TË TURQISË

Botimet e Kryesisë së Çështjeve Fetare të
Turqisë: 1312

Libra për fëmijë: 129

Drejtor publikimi
Dr. Fatih Kurt

Koordinator
Lokman Arslan

Mësoj lutjet e mia Autori:
Rabia Gülcan

Ilustroi me vizatime
Dağistan Çetinkaya

Drejtor botimi:
Mehmet Erdoğan

Drejtor viziv
Kadir Karsavul

Përktheu
Mr. Zymer Ramadani

Redaktor Gjuhësor
Fatjon Cuka

Redaktor Fetar
Florida Kulla

Dizajni
Uğur Altuntop
Erzen Pashaj

Vendimi i Këshillit të Lartë për
Çështjet Fetare 23.08.2016 / 51

2019-06-Y-0003-1312

ISBN : 978-975-19-6666-7

Certifikimi: 12930

Botimi 2, 2019

Shtypshkronja

Başak Mat. Tanı. Hiz. İth. İhr. Tic. Ltd. Şti.
+90 312 397 16 17

© Kryesia e Çështjeve Fetare të Turqisë

Kryesia e Departamentit të
Botimeve Fetare

Adresë kontakti:

Dini Yayınlar Genel Müdürlüğü
Yabancı Dil ve Lehçelerde Yayınlar
Daire Başkanlığı

Üniversiteler Mah. Dumlupınar
Bulvarı No: 147/A 06800
Çankaya – ANKARA / TÜRKİYE
Tel.: +90 312 295 72 81

Fax: +90 312 284 72 88

E-posta: yabancidiller@diyanet.gov.tr

PREZANTIM

Përsëndetje të dashur fëmijë!

A e dini se gjithësia në të cilën jetojmë, bashkë me të gjitha gjallesat e saj, i luten Krijuesit të Lartësuar? Pemët luten kur çelin lulet e tyre. Lumenjtë luten vazhdimisht ndërsa rrjedhin drejt detit. Cicërimat gazmore të zogjve janë një lloj lutjeje. Përse njerëzit nuk i bashkëngjiten këtij ritmi lutjesh? Ejani të bashkohemi edhe ne me lutjen e natyrës. T’u bashkohemi edhe ne lutjeve të deteve, lumenjve, pemëve dhe luleve. Ta falënderojmë Allahun për mirësitë e panumërta që na dhuroi. Ta madhërojmë atë, sepse na dhuroi shumë bukuri. Të bëjmë dua për nënat dhe baballarët tanë, për vëllezërit e motrat, si dhe për shoqërinë. Të bëjmë dua për fëmijët që janë në gjendje të vështirë për shkak të grindjeve të pakuptimta të të rriturve. Të lutemi për atdheun, për popullin tonë. Të hapim duart e vogla e të bëjmë dua kur shtrihemi në darkë në krevat. Gjithmonë të bëjmë dua kur zgjohemi në mëngjes. Të falënderojmë dhe madhërojmë Allahun për mirësitë që na dhuroi!

Të dashur fëmijë!

Në emër të Kryesisë së Çështjeve Fetare, më parë kemi botuar tri vepra për ju: “Mësoj fenë time”, “Mësoj për Pejgamberin”, “Mësoj librin tim”. Nuk mund ta dini sa lumturohemi kur shohim që ju i doni dhe i pëlqeni shumë këto vepra. Ato i përkthymë në gjuhë të ndryshme dhe i lexuan edhe bashkëmoshatarët tuaj që flasin këto gjuhë. Edhe atyre u pëlqen shumë.

Ndërsa tani ne përjetojmë lumturinë e paraqitjes së kësaj vepre për ju. Jemi të bindur që do ta pëlqeni edhe këtë, ashtu si të tjerat, dhe nuk do ta lëshoni nga duart. Do t’ju pëlqejnë lutjet që do t’i bëni me këtë libër. Përveç kësaj, do të mësoni se kur dhe si të bëni dua. Do të mësoni lutjet e të gjithë pejgamberëve, duke filluar nga Pejgamberi ynë. Mirëpresim letrat dhe e-mail-et tuaja në lidhje me këtë vepër. Ju jeni e ardhmja jonë dhe ne ju duam shumë.

KRYESIA E ÇËSHTJEVE FETARE TË TURQISË

M Ë S O J LUTJET E MIA



KRYESIA E ÇËSHTJEVE FETARE E TURQISË

ANKARA • 2019

Përmbajtja

KAPITULLI I	9
LUTJET JANË DËSHIRAT E MIA	9
Çdo gjë i lutet Atij	9
Allahu kërkon që të bëjmë dua	11
Allahu i dëgjon duatë tona	12
Po nëse duatë tona nuk pranohen.....	12
Zoti ynë u përgjigjet lutjeve tona	14
Duaja në çastet tona të gëzuara.....	14
Duaja në çastet tona të vështira	15
Duaja është dashuri dhe afrimetet	17
Duaja i fal bukuri jetës sonë	18
Duaja në çdo kohë dhe në çdo vend	19
Si të bëjmë dua.....	20
Duaja në jetën e Pejgamberit tonë.....	22
Shmanguni nga shprehja e nëmave/mallkimeve.....	25
KAPITULLI I DYTË.....	31
DUA NGA KUR'ANI I MADHËRUESHËM	
DHE NGA PEJGAMBERI YNË	31
Shembuj duash nga Kur'ani i Madhërueshëm.....	31
Duaja e fillimit të një pune ose fjale: Bismil'lah.....	31
Porta e hapur drejt pafundësisë: Surja Fatiha	35
Surja Fatiha ajet për ajet	35
Duaja me anë të Esmat Husna (Emrat e Bukur të Allahut).....	38
Duaja më e madhe: Ajeti Kursi	40
Duatë Rabbena	43
Suret Ihlas, Felek dhe Nas si dua.....	43
Lutjet që këndohen në namaz	43
Duaja Subhaneke.....	43
Duatë Kunut.....	44

Lutjet e Pejgamberëve që ndriçojnë rrugën tonë	45
Disa dua të Hz. Muhammedit (s.a.s.) që citohen në Kur'anin e Madhërueshëm.....	51
Edhe disa dua nga jeta e Pejgamberit tonë.....	51
Dua nga figura të njohura islame.....	53

KAPITULLI I TRETË..... 59

EDHE TI BËJ DUA 59

Të falënderosh me dua: Allahu qoftë i kënaqur me ty	59
Kur shtrihemi për të fjetur dhe kur zgjohemi nga gjumi.....	60
Dua që të jenë mburojë ndaj të këqijave.....	63
Duatë të shpëtojnë nga frika.....	63
Duatë largojnë mërzitë dhe pikëllimet.....	64
Duatë largojnë dyshimet	64
Duatë këndohen për shërim.....	65
Kam dëshirat e mia	66
Dua për gjyshërit, gjyshet dhe të afërmit.....	66
U larguan nga kjo botë, por ende janë në zemrën tonë	68
Dua për nënat, baballarët dhe vëllezërit tanë	69
Nëse është shoku ynë, ne e duam shumë.....	69
Duaja që këndohet kur dalim nga shtëpia dhe kur futemi në shtëpi.....	70
Shoku më i sinqertë në rrugën për në shkollë	71
Suksesi më i madh.....	71
Duaja që këndohet për lehtësim	73
Duaja në udhëtim.....	73
Hëngrëm dhe pimë, falënderimet qofshin për Krijuesin tonë.....	74
Ndërkohë që lutemi për begati.....	75
Dua kundrejt aksidenteve dhe fatkeqësive.....	75
Edhe nëse pendohemi, kemi diçka që mund të bëjmë.....	76
Dhurata më e bukur për të zotin e shtëpisë	76
Duatë i shtojnë gëzim gëzimit	77
Dua që të falin qetësi e prehje	77





KAPITULLI I

LUTJET JANË DËSHIRAT E MIA



*Pranë Allahut
nuk ka gjë më të vyer
sesa duaja.*

(Ibn Maxhe, "Dua", 1).



Çdo gjë i lutet Atij

Të gjitha gjallesat në sipërfaqen e tokës kanë nevojë për qiellin, ujin, dheun dhe diellin. Një foshnje i sapolindur ka nevojë për qumështin dhe kraharorin e mëshirshëm e të dhembshëm të nënës së tij.

Një farë ka nevojë për dheun, në mënyrë që të mbijë e të gjelbërohet. Dheu ka nevojë për shiun, ndërsa shiu për retë. Zogjtë kanë nevojë për pendët që të mund të fluturojnë, ndërsa peshqit kanë nevojë për ujin. Çdo gjallesë ka nevojë për ndihmën e një gjallesë tjetër, në mënyrë që të vijojë ekzistencën e saj. E vetmja qenie që nuk ka nevojë për asgjë, është Allahu i Lartmadhëruar. Sepse Allahu është Krijuesi i vetëm i të gjitha krijesave të universit. Është Ai që u jep jetë gjallesave. Asnjë gjallesë nuk mund të jetojë pa i dhënë Ai jetë dhe pa lejen e Tij asgjë nuk mund të bëhet. Çdo gjë ka nevojë për Të. Ndërsa Ai nuk ka nevojë për asgjë.



(Kujtoje) kur Zoti juaj kumtoi: “Nëse tregoheni mirënjohës, Unë do t’ju shtoj edhe më shumë begatitë e Mia, por, nëse ju mohoni mirësitë e Mia (atëherë dijeni se), dënimi Im është i rëndë”.

(Ibrahim, 14/7)



Planetët lëvizin me lejen e Tij. Me urdhrin e Tij ndriçojnë yjet. Dielli lind dhe perëndon me urdhrin e Tij. Me urdhrin e tij hëna zbukuron kupën qiellore. Ai është Zoti i qiejve dhe i tokës, i të gjithë krijesave, të gjalla ose jo.

Çdo frymëmarrje që realizojmë, çdo hap që hedhim, çdo gjë e re që mësojmë, çdo punë në të cilën kemi sukses, bëhet vetëm me urdhrin e Tij.

Ai e zbukuroi këtë botë të pafund për ne, Ai e krijoi ajrin që thithim, ujin që pimë. Ai krijoi hënën dhe yjet, në mënyrë që të mos mbetemi tërësisht në errësirë. Ai krijoi retë, në mënyrë që të bjerë shi, lumenjtë që të përballojmë nevojën për ujë. Ai i krijoi frutat dhe perimet, çdonjëren me ngjyrë, aromë dhe shije të ndryshme; grurin që të gatujmë bukë, kafshët, mishin e të cilave e hamë, qumështin e të cilave e pimë. Çdo gjë u bë ngaqë ai tha “bëhu”.

Çdo gjë e fillon ekzistencën me lejen dhe dëshirën e Tij. Nëse Ai nuk e lejon, a mund ta pimë ujin që kemi në dorë? A mund të dalim nga shtëpia e të shkojmë në shkollë, nëse Ai nuk na lejon? A mund ta kthejmë frymën që kemi marrë? Pa dyshim, asnjëren nga këto nuk mund ta bëjmë pa lejen e Allahut të Lartmadhëruar.

Ne flasim, dëgjojmë, mund të lëvizim dorën apo krahun, dhe të gjitha këto realizohen me lejen e Tij.

Çdo gjallesë flet me gjuhën e saj. Gjithë ç’ka në tokë e në qiej e lëvdon Allahun nëpërmjet gjuhës së vet. Çdo gjë e falënderon Atë me gjuhën e saj dhe shpreh dëshirën ndaj Tij.

Zogjtë cicërojnë në kor nga mëngjesi deri në mbrëmje; bletët shkojnë nga njëra lule te tjetra; milingonat mbartin ushqim në foletë e tyre; një farë, e cila dëshiron që prej saj të rritet një pemë, hidhet në tokë, pret që t’i vijë uji dhe kërkon diell. Ajo lutet ndaj Allahut në gjuhën e saj: “Më rrit mua, më fal degë dhe trungje, që njerëzit të kenë dobi nga unë.”



Çdo krijesë gëzohet për begatitë që i janë dhënë. Të gjithë bëjnë dua, shprehin falënderim ndaj atij që i ka falur të lumtur. Të gjitha falënderimet dhe lëvdimet janë për Të.

Allahu kërkon që të bëjmë dua

Dielli lind për ne çdo mëngjes. Zogjtë që cicërojnë zhurmshëm dhe gazmorë, bletët bëjnë mjalhtë, fluturat fluturojnë, lulet janë shumëngjyrëshe, përrrenjtë dhe lumenjtë rrjedhin me gurgullimë... Të gjitha këto janë vetëm për ne.

Ne ndiejmë dashuri dhe respekt të pafund ndaj Allahut, për shkak të atyre që na ka dhuruar. Krijuesi ynë na do shumë. Na vlerëson kaq shumë, pikërisht sepse na do. Është i paktë falënderimi ynë ndaj Allahut të Lartmadhëruar, i cili na dhuroi hundë për të nuhatur, duar për të kapur gjëra, gjuhë për të shijuar, sy për të parë, veshë për të dëgjuar, këmbë për të vrapuar dhe që na ka krijuar nga një nënë e një baba.

Nëse shoku ynë na bën një dhuratë, ne nuk harrojmë ta falënderojmë atë. Sepse ne e kuptojmë që shoku ynë na çmon. Dashurinë që kemi ndaj prindërve e shprehim në forma të ndryshme. Sepse asnjëherë nuk e harrojmë mundin e tyre ndaj nesh. Vallë, a mund ta harrojmë Allahun e Lartmadhëruar, që na dhuron dhjetëra bukuri, na ofron mirësi të ndryshme? A nuk kemi ndonjë detyrim ndaj Tij? Padyshim që po. Detyra e parë ndaj Tij është që ta duam Atë, të respektojmë urdhëresat e Tij, ta falënderojmë Atë për bukuritë dhe mirësitë e panumërta që na ka dhënë.

Falënderimin tonë kundrejt Allahut mund ta shprehim vetëm duke kryer adhurim ndaj Tij dhe duke bërë dua.



“Allahu e dëgjon bisedën tuaj, Allahu dëgjon çdo bisedë dhe sheh çdo punë.

(Muxhadele, 58/1)





*Atij i përket fshehtësia
e qiejve dhe e Tokës.*

*Eh, sa mirë
sheh Ai çdo gjë dhe sa
mirë që dëgjon!*
(Kehf, 18/26)



Zoti ynë i do ata që e falënderojnë përmes adhurimeve dhe duave. Ai ua rrit shpërblimet dhe begatitë atyre që e falënderojnë Atë.

Allahu i dëgjon duatë tona

Allahu i Lartmadhëruar, ekzistencës së të cilit i besojmë, i Cili është zotërues i mëshirës dhe i dhembshurisë së pafund, na do shumë ne, por edhe ne e duam shumë Atë. Ia parashtrijmë Atij dëshirat dhe kërkesat tona, bëjmë dua ashtu siç na vjen më mbarë. Ai i di, madje, edhe problemet më të vogla, brengat e shqetësimet më të fshehta. I di surprizat që do t'u bëjmë shokëve dhe shoqeve. Di ëndrrat tona më të largëta dhe i realizon ato që dëshirojmë ne. Sheh çdo situatë tonën, dëgjon zërin tonë.

Në një vend ku askush nuk mund ta dëgjojë zërin tonë, Ai e dëgjon. Aty ku askush nuk mund të na shikojë, Ai na sheh. Në rastet kur askush nuk mund të na ndihmojë, Ai na ndihmon.

Duke qenë se Allahu dëgjon çdo gjë, në këtë mënyrë Ai dëgjon edhe duatë tona. Si rrjedhojë, Ai e di se si ne e përmendim me respekt dhe mirënjohje ndaj mirësive që na ka dhuruar. Sido që t'i shprehim duatë, nga brenda vetes, me zë të ulët apo me zë të lartë, ai me siguri na dëgjon.



Po nëse duatë tona nuk pranohen...

Të shprehim dua është diçka që na përket ne, ndërsa pranimi i përket Allahut. Zoti ynë, i cili i dëgjon duatë tona, pa dyshim që do t'u përgjigjet atyre. Mirëpo përgjigjet nuk nënkuptojnë gjithmonë realizimin e asaj që kemi dëshiruar kur kemi shprehur duanë. Ajo që na përket ne është ta vijojmë duanë me durim. Për këtë arsye, nuk duhet të themi: "Kërkova një herë, por nuk u bë." Duhet të vijojmë të shprehim dua. Mos të harrojmë se, në një kohë më të përshtatshme, Zoti ynë do të na përcjellë drejt rezultatit më të mirë për ne.



*Allahu ua pranon
duatë tuaja. Por
mos u nxitoni në
realizimin e tyre; mos
thoni se bëra dua, por
nuk m'u pranua.*
(Tirmidhi, Deavat, 12)

Sepse vetëm ai mund të dijë më mirë atë çka është më e duhur dhe e nevojshme për ne. Nëse dëshiron Ai, e realizon kërkesën tonë ashtu siç duam ne, nëse dëshiron na jep më tepër dhe diçka më ndryshe, nëse do, nuk na e dhuron në këtë botë atë që dëshirojmë, por na e jep në ahiret, në botën e amshueshme.

Zoti ynë u përgjigjet lutjeve tona

Ai është Zoti i gjithçkaje. Zotëron mëshirë dhe është i mëshirshëm. Mëshira e Tij përfshin gjithçka. E do shumë atë që hap duart dhe i drejtohet Atij, atë që i përgjërohet dhe kërkon nga Ai.

Ai i përgjigjet kërkitimit të një milingone për risk, qarjes së një fëmije, na ushqen kur jemi të uritur, na dërgon ujë nëpërmjet reve dhe lumenjve, na shëron kur sëmuremi, na mbron nga të këqijat.

Ai na largon brengat dhe problemet tona, na mbush zemrat me prehje e lumturi. Kur bëjmë ndonjë gabim, kërkojmë falje prej Tij. Sepse ai ka mëshirë të pafundme dhe fal shumë.

Për Të nuk është e vështirë të plotësojë dëshirën tonë, qoftë ajo e vështirë apo e lehtë, e madhe apo e vogël. Qoftë në këtë botë apo në botën tjetër, ai i plotëson të gjitha dëshirat tona, duke respektuar mirësinë tonë. Ai e tregon gjerësinë e mëshirës së tij duke iu përgjigjur duave tona. Zoti ynë është gjithmonë me ne. Sa mirë është të ndajmë gëzimet dhe hidhërimet me të!

Duaja në çastet tona të gëzuara

Kur gëzohemi për diçka, dëshirojmë që atë gëzim ta ndajmë me njerëz të tjerë. Ne gëzohemi kur kalojmë klasën, por edhe kur marrim nota të mira në mësim.



Lumturohemi kur kemi datëlindjen, në festat e Bajramit, në dasma, lumturohemi kur takohemi me një të afërm të ardhur nga larg dhe kërkojmë ta ndajmë gëzimin me njerëzit e tjerë. Në raste të tilla, duhet të tregojmë se nuk kemi harruar edhe Allahun, i cili mundëson që ne të përjetojmë çaste të gëzuara dhe të shprehim dua ndaj Tij. Të bësh dua në kohë të gëzuara, do të thotë të shprehësh ndjenjën e respektit dhe të mirënjohjes ndaj Allahut. Nëse veprojmë kështu, Allahu do të jetë i kënaqur me ne.

Për shembull, ne gëzohemi kur një i afërm yni, apo vetë ne, shpëtojmë prej ndonjë sëmundjeje ose aksidenti. Ne shprehim dua me gëzim ndaj Allahut, ngaqë na ka ruajtur, na ka dhënë shëndet dhe qetësi. Ne e falënderojmë Allahun kur kalojmë klasën, ngaqë Ai na e mundësoi këtë lumturi dhe gëzim. Çdo fjalë që themi, në kuptimin e falënderimit të Allahut kundrejt një ngjarjeje, prej së cilës ndiejmë lumturi, është dua. Atëherë, le të mos bëjmë dua vetëm në çastet kur humbasim ndonjë të afërm, në rast sëmundjeje apo edhe në kohë të vështirë, por të lutemi edhe në çastet e bukura dhe të lumtura.

Njësoj siç arrijmë të rezistojmë nëpërmjet duasë, kur shprehim durim ndaj vështirësive dhe problemeve, po ashtu, duhet të bëjmë dua edhe me qëllim që gjërat e mira a të bukura që kemi, të mbeten tonat.

Duaja në çastet tona të vështira

Njeriu nuk mund të jetë i njëjtë në çdo çast. Ndonjëherë ai mund të jetë i gëzuar, ndonjëherë i pikëlluar, herë tjetër mund të përjetojë çaste të vështira. Duke menduar se disa situata janë të pazgjidhshme dhe se nuk mund të bëjë asgjë, njeriu rrezikon të bjerë në pesimizëm. Për shembull, e ndien veten të pashpresë kur sëmuret ose kur humbet një të afërm. Ja, pra, në këto raste duhet të lutemi, sepse kjo i sjell njeriut besim, forcë dhe siguri, po ashtu i mundëson të jetë i durueshëm dhe me shpresë. Sepse personi që bën dua, e di se Allahu është i aftë për gjithçka, se mund ta ndihmojë atë.



Vërtet, Allahu e bekon të Dërguarin dhe melekët e Tij luten për atë. O besimtarë, lutuni për Atë dhe përshëndeteni me "selam"!

(Ahzab, 33/56)





Në këtë mënyrë, ai mbështetet tek Allahu, me qëllim që t'i largojë brengat dhe pikëllimet. Qetësohet duke i ndarë problemet me të dhe ndien rehati, gjen besim te vetja dhe forcë për të tejkaluar problemet. Për shembull, kur personi merr një notë të ulët në mësim, nuk bie në pesimizëm, por i mëson më mirë mësimet, i bën detyrat në kohë, më pas bën dua duke thënë: “Allahu im, më ndihmo në mësimet e mia, më ndihmo që të jem i suksesshëm.” Kur sëmuret shkon te doktori dhe shërohet, pas kësaj i shpreh dëshirën Allahut duke thënë: “Allahu im, më jep shëndet.” Bën dua ndaj Allahut jo vetëm që të largojë nga ai problemet dhe pikëllimet, por edhe për të tjerët.

Duaja është dashuri dhe afritet

Allahu i do të gjithë krijesat që ka krijuar. Ndër krijesat e Tij, njeriu ka një vend të veçantë. Sepse Allahu e ka pajisur njeriun me karakteristika të tilla si: intelekti dhe të menduarit, karakteristika këto që nuk i zotërojnë gjallesat e tjera. Po ashtu, çdo gjë në univers është ofruar në shërbim të tij. Të gjitha këto tregojnë se Allahu e do njeriun dhe i jep vlerë atij.

Edhe ne e duam një njeri, të cilin e dimë se mendon për të mirën tonë. E ndiejmë veten më të afërt me të. Dashuria e tij prodhon dashuri. Këtë dashuri ia themi atij me fjalë dhe ia tregojmë nëpërmjet sjelljeve tona. Shprehja e dashurisë në këtë mënyrë ndikon në rritjen e saj dhe mundëson që ne të jemi më të afërt me të. Në të njëjtën mënyrë, lidhemi me dashuri ndaj Allahut që na do, që krijon bukuritë përreth nesh dhe i vë ato në shërbimin tonë. Dashurisë dhe afërsisë së Tij i përgjigjemi duke u lutur. Në lutjet tona shprehim dashurinë që kemi ndaj Tij. Mendimet dhe ndjenjat tona ia përcjellim Allahut, i cili ka fuqi për gjithçka; dëshirat tona i ndajmë me të dhe kërkojmë ndihmë prej Tij.



*Bëni dua ndaj Allahut,
duke besuar se do të
pranohet në
mënyrë të sigurt.*

(Tirmidhi, Deavat, 66)



Në këtë mënyrë rritet dashuria dhe afrimiteti mes nesh dhe Allahut. Sepse njeriu që e di se Allahu është gjithmonë pranë tij dhe se nuk do ta privojë ndihmën nga ai, bën dua duke iu drejtuar Atij me dashuri dhe respekt. Ndërkohë, kur bën dua, ndien qetësi dhe lumturi në vetvete, i pakësohen frikërat.

Këndimi i duave nuk krijon dashuri dhe afrimitet vetëm mes njeriut dhe Allahut, por edhe mes njeriut dhe njerëzve të tjerë. Sepse njeriu që bën dua, dëshiron të mirën e të gjithëve.



Në jetën tonë të përditshme themi fjalë, në cilësinë e duasë, në lidhje me të dashurit tonë, shprehim dëshira të mira për ta. Për shembull, falënderojmë atë që bën mirësi. U themi “Udhëtim të mbarë!” “Paç rrugë të mbarë!” atyre që nisen për udhëtim. Pasi ushqehemi, bëjmë dua ndaj atyre që e kanë përgatitur ushqimin, duke thënë: “Ju lumshin duart, paçi bereqet!” Ndaj një të sëmuri themi: “Të shkuara, të uroj shërim të shpejtë!” Ndërsa për të afërmit tonë të vdekur themi: “Allahu e mëshiroftë!” Të gjitha këto fjalë janë dua, që përmbajnë dëshira të mira. Nëse bëjmë dua duke thënë këto shprehje, nëse bëjmë dua për shëndet dhe lumturi jo vetëm për vete, por edhe për njerëzit e tjerë, kjo mundëson formimin e dashurisë dhe të afrimitetit mes njerëzve. Sepse njeriut i pëlqen që dikush të shprehë dëshira të mira për të.

Duaja i fal bukuri jetës sonë

Ne erdhëm në botë me dua. Na u këndua ezan dhe kamet në vesh. Më pas, të rriturit u lutën që ne të bëhemi njerëz të mirë, bij të mbarë për atdheun dhe popullin. Me dua arritëm në moshën shkollë. Nëna dhe babai ynë na çuan në shkollë duke thënë: “Biri im, Allahu i Lartmadhëruar të dhëntë sukses në mësim!” Me dua filluam ditët e shkollës.



Babai shkon në punë me dua. Fara e bukës që hamë hidhet me dua në tokë. Me dua vaditen kopshtet. Nëna i gatuan ushqimet më të shijshme me dua. Me dua shtrohen dhe ngrihen sofrat. Të afërmit tanë, që kanë arritur moshën e martesës, përcillen me dua nga shtëpia. U këndojmë dua të sëmurve kur shkojmë për vizita, në mënyrë që të gjejnë shërim. Nisemi për udhë me dua. Me dua shkojnë vëllezërit tanë të mëdhenj në ushtri. Me dua përcillen të vdekurit në ahiret. Ne lindim me dua, rritemi me dua dhe me dua takohemi me krijuesin tonë. Shkurtimisht, jeta e një muslimani do të thotë dua.

Duaja në çdo kohë dhe në çdo vend

.Pa dyshim që njerëzit mund t'i shprehin dua Allahut në çdo vend, në çdo mjedis dhe për çdo gjë që dëshirojnë. Sepse të bësh dua, të përmendësh Allahun, kudo që të ndodhesh, do të thotë që ne nuk harrojmë se ai është shumë afër nesh.

Nuk ka ndonjë vend të veçantë për duanë. Duke shkuar në shkollë, kur kthehemi në shtëpi, kur shtrihemi për të fjetur, kur zgjohemi në mëngjes, kur qëndrojmë ulur, kur mësojmë, kur shëtisim në treg, kur ecim me biçikletë, në çdo kohë dhe në çdo vend mund të bëjmë dua, ashtu siç na vjen më mbarë.

Gjithashtu, mund të bëjmë dua edhe për shëndetin dhe lumturinë tonë, për suksesin e shokëve dhe të mësuesve tanë. Nuk ka një afat të caktuar kohor për përgjërime ndaj Zotit tonë të Lartë. Mund të bëjmë dua në çdo minutë të njëzet e katër orëve të ditës. Mirëpo e dimë se duaja më e pranuar është duaja që bëjmë kur jemi më vete dhe nata është njëra prej periudhave kohore më të përshtatshme për dua.

Ashtu siç kemi mësuar nga Pejgamberi ynë i dashur, Allahu i Lartmadhëruar e pranon duanë e atyre që luten gjatë natës. U plotëson dëshirat dhe kërkesat atyre që kërkojnë diçka nga Ai.



Fal ata që kërkojnë falje. Kështu që edhe ne, duke respektuar këtë këshillë të Pejgamberit tonë, duhet të këndojmë më shumë dua gjatë natës. Përveç kësaj, netët e premtë dhe netët e mira janë një mundësi për pranimin e duave të përzemërta. Në këto net mund të bëjmë dua me të rriturit tanë. Mund të shkojmë bashkërisht në xhami dhe mund të marrim pjesë në ato dua të bukura që bëhen kolektivisht. Allahu i Lartmadhëruar i do shumë duatë që bëjnë besimtarët në mënyrë kolektive dhe përzemërsisht.



Si të bëjmë dua

Duaja i drejtohet vetëm Allahut. Personi ia përcjell Allahut dëshirat dhe kërkesat duke bërë dua. Ashtu siç i vjen për mbarë me fjalët e tij, i shpreh Allahut ndjenjat dhe mendimet.

Të bësh dua është shumë e thjeshtë. Nuk ka shumë rregulla për të filluar duanë, ashtu siç ka në adhurime. Mirëpo, para duasë duhet të bëhen disa përgatitje. Së pari, duhet të përgatisim mendimet dhe ndjenjat tona për dua. Nuk duhet të kemi në një vend mendjen, e në një vend tjetër gjuhën; duhet të dimë se ç'themi, duhet të kuptojmë si të bëjmë dua.

Në mënyrë që duaja jonë të pranohet, duhet të kryejmë disa mirësi para saj. Mund të bëjmë mirësi ndaj nënës dhe babait, ndaj shokëve dhe fqinjëve tanë; mund të shprehim dashuri ndaj kafshëve dhe bimëve.

Marrja e abdesit para duasë është një sjellje e bukur. Nëse gjatë duave u kushtojmë rëndësi disa kritereve, në këtë mënyrë kemi zbukuruar duatë tona. Para se të fillojmë duanë duhet të citojmë këto dy fjalë: “hamd” dhe “salavat” e dyta. Hamd do të thotë të lëvdosh dhe të lartësosh Allahun e Lartmadhëruar. Duatë duhet t'i nisim me lëvdim ndaj Allahut të Lartmadhëruar. Ai është i denji për lëvdim dhe falënderim. Sepse të gjitha



bukuritë në univers ekzistojnë bashkë me krijimin e Tij. Është Ai që i dërgon të gjitha mirësitë, që i krijon të gjitha, që u jep jetë dhe që i ushqen. Çdo lloj lëvdimi dhe falënderimi i përket atij. Ashtu siç mund ta shprehim lëvdimin ndaj tij në formën “Allahu im i lartë! Të falënderoj ty”, po ashtu mund të këndojmë edhe ajetin e parë të sures Fatiha, të cilën e themi në çdo namaz: “Elhamdulil’lahi Rabbil alemin.” Pasi të themi këtë, nuk duhet të harrojmë të këndojmë dua edhe për Pejgamberin tonë të dashur. Duaja që bëjmë për të quhet “salavat”. Ndërsa fjalia që shprehet në salavat është kjo: “Allahumme sal’li ala Muhammedin ue ala ali Muhammed”. Kuptimi i kësaj fjalie është si më poshtë: “Allahu im, mëshiro edhe Pejgamberin tonë të dashur, Muhammedin, familjen dhe të afërmit e tij!” Përkthimin në shqip të kësaj fjalie mund ta këndojmë në formën e salavatit.

Fillimi i duave tona me lëvdim ndaj Allahut dhe salavat ndaj Pejgamberit tonë të dashur lehtëson pranimin e tyre. Allahu i Lartmadhëruar ndien kënaqësi kur bëjmë dua në këtë mënyrë. Sepse Zoti ynë e do shumë Pejgamberin tonë të dashur. Edhe ne e duam atë më shumë se jetën tonë. Sa shumë gëzohemi nëse dikush na sjell përshëndetjen dhe selamin e dikujt që është larg dhe që e duam shumë? Edhe të përmendësh emrin e Pejgamberit tonë është kështu.

Pas të gjitha këtyre, mund të bëjmë dua duke veçuar ndër duatë e përzgjedhura që citohen në Kur’an, ose nga duatë që ka kënduar Pejgamberi ynë i dashur. Po ashtu, mund të bëjmë dua edhe ashtu siç na vjen për mbarë.

Për dua nuk është posaçërisht e nevojshme që t’i ngremë duart lart, por hapja lart e duarve është një shenjë e kërkesës dhe e përgjërimit. E rëndësishme në dua është që të kërkojmë nga Allahu përzemërsisht dhe larg dukjes e demonstrimit.



Le t'i bëjmë duatë ashtu siç na vjen më mbarë nga brendësia jonë. Fjalitë e duasë të jenë të thjeshta dhe të qarta. Allahu i Lartmadhëruar i do duatë e bëra nga brendësia e zemrës, i pranon ato. Zoti ynë nuk sheh fjalët, por entuziazmin në zemrën e robit, përzemërsinë në fjalët e tij.

Po ashtu, nuk është e nevojshme që duatë t'i bëjmë me zë të lartë. Allahu i Lartmadhëruar është në dijeni të çdo gjëje që na kalon në mendje dhe në zemër. Mund të bëjmë dua me një zë që të mund ta dëgjojmë ne vetë.

Ndërkohë, kur bëjmë dua, le të kërkojmë nëpërmjet tyre gjërat më të bukura nga Zoti ynë i Lartësuar. Ashtu si në rastin kur kërkojmë diçka nga një i rritur, që tregojmë kujdes dhe respektojmë rregullat e mirësjelljes, më shumë se kaq duhet të tregojmë kujdes edhe kur kërkojmë diçka nga Allahu i Lartmadhëruar. Kërkesat ndaj tij duhet t'i shprehim nëpërmjet fjalish të mbushura me dashuri dhe respekt. Ndërkohë, krahas gjërave që do të kërkojmë në këtë botë, të mos harrojmë të kërkojmë edhe lumturinë e ahiretit nga Zoti ynë. Sepse ahireti është vendbanimi ynë i fundit. Lumturia e botës së amshueshme është shumë e rëndësishme për ne. Po ashtu, mirësitë dhe bukuritë të mos i duam vetëm për vete, por për të gjithë njerëzimin.



Duaja në jetën e Pejgamberit tonë

Nga veprimtaritë e Pejgamberit tonë të dashur, mësojmë se jeta ka një vend të rëndësishëm. Atij i pëlqente shumë të bënte dua dhe të mbështetej tek Allahu. Çdo punë e fillonte me dua. Edhe muslimanët i këshillonte të bënin dua sa më shumë, të mos e fillonin asnjë punë pa dua.

Ai nuk bënte dua vetëm për veten, por edhe për shpëtimin e të gjithë njerëzimit.

Ndërsa bënte dua, sidomos pas namazeve për mirësi të muslimanëve në botë dhe në ahiret, thoshte se duatë më të vyera janë ato “që bëjnë besimtarët për njëri-tjetrin”. Edhe ne nuk duhet të harrojmë të bëjmë dua për ata që duam.

Pejgamberi ynë i dashur, në jetën e tij të përditshme, bënte dua në këto raste:

Pejgamberi ynë bënte dua kur dilte nga shtëpia ose nga xhamia, në mënyrë që të kishte mirësi dhe bukuri. Në të njëjtën mënyrë bënte dua edhe kur hynte në këto vende.

Nuk neglizhonte të bënte dua edhe ndaj bashkëshorteve dhe fëmijëve të tij. Ata ia besonte Allahut të Lartmadhëruar.

Para se të nisej për udhë, bënte dua që udhëtimi të shkonte mirë dhe pa aksidente apo ndodhi të pakëndshme. Edhe kur kthehej nga udhëtimi mbështetej tek Allahu, në mënyrë që ta gjente familjen me shëndet dhe me lumturi.

Po ashtu, nëse një i afërt ose shoku i tij nisej për një udhëtim të gjatë, i shtrëngonte dorën, e përqafohte, bënte dua ndaj Allahut që t'i shkonte udhëtimi mirë dhe e përcillte me dëshira të mira.

Kur fillonte një punë, bënte dua që ajo të ishte e lehtë, të mos shfaqeshin vështirësi në atë punë.

Kur fillonte ndonjë mbledhje ose bisedë me shokët, i përgjërohej Allahut, në mënyrë që mbledhja të shkonte sa më mirë. Ndërsa kur përfundonte mbledhja dhe biseda, i kërkonte Allahut i Lartmadhëruar që ta falte për ndonjë gabim që mund të kishte kryer pa dashje.

Kur nisej për shitblerje, bënte dua ndaj pronarëve të dyqaneve, në mënyrë që punët t'i shkonin me fitim.







Ai i donte shumë fëmijët. Prindërit, sapo të lindnin fëmijët, i dërgonin ata te Pejgamberi ynë i dashur, në mënyrë që të këndonte dua. Ai i merrte në prehër, i puthte, i përkëdhelte; bënte dua që të ishin jetëgjatë dhe njerëz të mirë.

Ai vizitonte ata që kishin shqetësime dhe probleme nga myslimanët, ose ata që ishin sëmurë dhe bënte dua që të shëroheshin.

Nuk neglizhonte duatë para dhe pas të ushqyerit. Në veçanti bënte dua që ushqimi të ishte i begatë, mbështetej tek Allahu i Lartmadhëruar nga uria.

Edhe kur shtrihej në krevat, nuk harronte të bënte dua. Këndonte suret Ihlas, Felek dhe Nas, bënte dua duke u mbështetur tek Allahu, që të zgjohej në mirësi. Në mëngjes, ndërsa zgjohej energjik dhe mirë, falënderonte Allahun.

Kur binte shi, bënte dua që tokat e vendit të tij të ishin të begata dhe që kafshët të mos mbeteshin pa ujë. Mbështetej tek Allahu nga tërmeti dhe përmytjet, nga çdo lloj e keqeje dhe sulmi nga armiqtë.

Pejgamberi ynë na mësoi të bëjmë dua. Edhe ne bëjmë dua në mënyrën që na ka mësuar ai.

Shmanguni nga shprehja e nëmave/mallkimeve

Feja jonë, Islami, nuk e toleron kurrë shprehjen e dëshirave negative ndaj dikujt. Allahu i Lartmadhëruar nuk i pëlqen duatë negative në formën “Allahu të dhëntë belanë!”, Allahu të shkatërroftë!”, “Allahu të verboftë!”



Për këtë arsye, aq sa duam mirësinë për të dashurit, duhet të dëshirojmë edhe mirësinë e personave që nuk i duam. Mos të harrojmë, Pejgamberi ynë i dashur është një pejgamber mëshire.

Të marrim shembull Pejgamberin tonë të dashur në çështjen e duasë. Në periudhën e Mekës, kur vajti në Taif, me qëllim që të shpallte Islamin, u përball me një sjellje të keqe; ndërsa kthehej, ra pre e goditjeve me gurë dhe ishte gjakosur ndërkohë kur ishte koha e muajve të bekuar. Në atë kohë i bëhet e ditur nga Allahu se “mallkimi që do të bënte kundrejt tyre do të pranohej dhe se mund t’i shkatërronte ata, nëse kishte dëshirë”, mirëpo Pejgamberi ynë tha: “Jo, sepse ndoshta nga fisi i këtyre lindin fëmijë që do të të adhurojnë Ty, Allahu im!” Ndërsa për armiqtë që i thyen dhëmbin në Uhud dhe që e plagosën në fytyrë, bëri dua duke thënë: “Allahu im! Udhëzoje në rrugë të drejtë popullin tim, sepse ata nuk dinë ç’bëjnë.”

Kur marrim shembull Pejgamberin tonë dhe veprimet sipas tij, gjithmonë do të duam mirësinë e njerëzve. Edhe nëse dikush tjetër do të na bëjë keq, bëjmë dua që ai të jetë një njeri i mirë dhe që të braktisë të këqijat. Edhe në situatën më të vështirë, nuk duhet të nxjerrim fjali të këqija nga goja. Personat e këqij i lëmë në dorë të Allahut. Ai bën atë që nevojitet me ta. Sepse ai i vlerëson ata që janë të mirë. Ndërsa dënon ata që nuk pendohen, që nuk ndiejnë pendim për veprimet e kryera dhe që vijnë të bëjnë keq.

Atëherë le të bëjmë dua që të këqijtë të jenë njerëz të mirë dhe të largohen nga të këqijat e tyre. T’i hapim duart drejt Allahut, të përgjero kemi që në botë të këqijtë dhe të këqijat të mos shtohen. Të kërkojmë nga Allahu i Lartmadhëruar një botë plot dashuri dhe paqe.



Le të lexojmë: JI KËSHTU DHE KËSHTU FLIT

(...)

Së pari, fjala bismil'lah,
më e bukura fjalë.

Allahu im,
mos ma lësho dorën
gjatë gjithë rrugës,
se pastaj rrëzohem.

Allahu im,
thujaja qartë zemrës sime
se për çfarë më ke krijuar,
kështu që udha ime të pastrohet
nga pengesat.

Allahu im,
ashtu siç janë të ndritur,
po edhe të bukur robërit që do,
edhe mua atë bukuri më fal.

Allahu im,
çfarëdo mirësie të ketë dëshiruar nga Ti,
Ai, i bukuri i të bukurve,
edhe unë të njëjtat dëshiroj.

Allahu im,
nga çdo e keqe që Ai,
Zotëria ynë, Pejgamberi
është mbështetur te Ti,
edhe nga unë mbaji sa më larg të mundesh ato të këqija.

Allahu im,
mos na lër vetëm
gjatë gjithë udhës
e gjatë gjithë historisë.

Cahit Zarifoğlu








TI DËGJON

Zërat pëshpëritës,
dëshirat dhe zelli që kemi në zemër,
frymëmarrjet më të dobëta,
Ti e dëgjon, Allahu im.

Bubullimën e qiellit,
shushurimën e ujit,
pëshpëritjen e duasë,
Ti e dëgjon, Allahu im.

Çfarëdo të thonë bletët,
çfarëdo duaje të shprehin zogjtë,
nëse një fëmijë "Allah" thotë,
Ti e dëgjon, Allahu im.

M. Yaşar Kandemir



DUA NGA KUR'ANI I MADHËRUESHËM DHE NGA PEJGAMBERI YNË



*Lutmuni Mua, se do
t'ju përgjigjem!*

(Mumin, 40/60)



Shembuj duash nga Kur'ani i Madhërueshëm

Në Kur'anin e Madhërueshëm Zoti ynë na tregon se si të bëjmë dua. Jep shembuj nga duatë e pejgamberëve, të robërve të mirë dhe të dashur, të njerëzve të pashpresë që kanë pësuar padrejtësi.

Fatihaja, si sureja e parë e Kur'anit të Madhërueshëm, është një dua më vete. Edhe në suret e tjera ka dua. Zoti ynë dëshiron që këto të mos i këndojmë vetëm për vete, por edhe për të tjerët.



Duaja e fillimit të një pune ose fjale: Bismil'lah

Ne i besojmë njëjesisë dhe ekzistencës së Allahut. E duam shumë Atë, ngaqë na ka dhënë mirësi të pafund.

*“Duaja është thelbi i
adhurimit”*

Tirmidhi “Dua” 1



Për të shprehur dashurinë dhe vartësinë që kemi ndaj Tij, e fillojmë çdo punë me emrin e Tij, pra duke shprehur fjalën bismil’lah.

Të thuash bismil’lah do të thotë të thuash “Bismil’lahirrahmanirrahim”. Kjo fjalë ka kuptimin: “Në emër të Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit”. Ndërsa fjala bismil’lah është shkurtimi i shprehjes së mësipërme dhe do të thotë: “filloj me emrin e Allahut”.

Pejgamberi ynë i dashur ka thënë se një punë e nisur pa bismil’lah do të jetë e pasuksesshme, se ushqimi i ngrënë pa bismil’lah nuk do të jetë i begatë. Për këtë arsye, kur nisim punët tona të përditshme, shprehim fjalën bismil’lah. Për shembull, kur nisemi për udhë, kur hapim një dyqan, kur mësojmë, kur fillojmë të ushqehemi, kur shtrihemi dhe kur zgjohemi, themi bismil’lah. Kështu shprehim dua ndaj Allahut:

“Allahu im, Ti je ai që krijon çdo gjë, të gjallë ose jo, që e ushqen, e rrit dhe që kujdesesh për të. Ti je Ai që më krijon mua dhe që më jep jetë. Po ashtu, Ti je Ai që më jep zgjuarsi dhe forcë. Mirëpo forca ime nuk është e mjaftueshme për çdo gjë. Përmendja e emrit tënd, mua më jep forcë dhe lehtësi. Prandaj, edhe unë i filloj punët e mira duke përmendur emrin tënd. Më ndihmo mua. Ty të mjafton forca për çdo gjë.”

Fjala bismil’lah, ashtu si një çelës që hap çdo portë, ndikon, lehtëson dhe begaton çdo punë, në fillim të së cilës është thënë ajo. Kur fillojmë një punë duke përmendur emrin e Allahut, Allahu na ndihmon dhe e lehtëson punën tonë. Duke thënë fjalën bismil’lah, kemi përmendur Allahun, kemi treguar se i besojmë Atij, se jemi rob i Tij dhe se kërkojmë ndihmë nga Ai. Sepse e dimë se pa qenë ndihma e Allahut, nuk mund ta përfundojmë me sukses një punë. Duke thënë fjalën bismil’lah freskojmë besimin që kemi ndaj Tij, dashurinë që ndiejmë për Të dhe e dimë se Allahu është në çdo çast me ne.

Çdo mëngjes për ne lind një ditë e re. Në mëngjesin e kësaj dite, kur zgjohemi nga shtrati dhe përmendim emrin e Allahut, i Cili na e mundësoi këtë, gjatë gjithë ditës në vijim përhapet një bukuri, prehje e qetësi, ashtu si një gur i vogël i hedhur në liqen, që e shndërron në dallgë të gjithë rrëkenë e ujit. Po ashtu, të thuash bismil’lah ka këtë kuptim: “Allahu im, me forcën që më dhe ti, po nis ditën e re që ke krijuar; ndërsa nis këtë ditë të re, të përmend ty, drejtohem drejt Teje dhe kërkoj ndihmë nga Ti, më mbro mua nga të këqijat dhe më drejto te mirësitë, mbushe ditën time me bukuri!”

Pejgamberi ynë i dashur urdhëron kështu: “Kushdo që, kur del nga shtëpia, thotë bismil’lah, përmend emrin e Allahut, thotë se besova në Allah dhe forca që do të më mbrojnë nga të këqijat e që do të më drejtojnë në mirësi është nga Allahu, atij i thuhet kështu: ‘U drejtove drejt udhës së duhur, u plotësuan nevojat e tua dhe u mbrojte nga të këqijat.’” (Ebu Davud, Edeb, 103)

Edhe kur të ulemi në sofër, nuk duhet ta harrojmë fjalën bismil’lah. Sepse në sofrën ku ulemi, gjejmë begati të llojlojshme, të cilat i ka parashtruar Allahu. Po ashtu, kur themi bismil’lah përpara se të fillojmë të ushqehemi, kemi shprehur falënderim për çdo kafshatë që do të hamë. Kujtojmë se është Allahu ai që fal mirësi, i bëjmë të ditur Atij falënderimin dhe dashurinë. Dhe, ngaqë falënderojmë, na mbushet zemra me paqe e qetësi. Sepse Allahu urdhëron kështu në Kur’an: “Prandaj, më kujtoni Mua (me namaz e lutje), që Unë t’ju kujtoj (me shpërblime) dhe falënderomëni Mua (duke M’u bindur) e mos i mohoni dhuntitë e Mía (me mosbindje)!” (Bakara, 2/152)

Çdo ditë fillon me emrin e Allahut. Gjërat që ndodhin brenda ditës, ndodhin me emrin e Allahut dhe dita përfundon me emrin e Allahut. Ikën dita e vjen nata.



“E kur robët e Mi të pyesin ty për Mua, Unë jam afër, i përgjigjem lutjes kur lutësi më lutet, pra për të qenë ata drejt të udhëzuar, le të më përgjigjen ata Mua dhe le të më besojnë Mua”.

(Surja el-Bekare, ajeti 186)





Zoti ynë ka krijuar natën, e cila është si një pëlhurë që mbulon të gjitha gjallesat e që na mbështjell si një jorgan, me qëllim që të prehemi e të zgjohemi energjikë ditën tjetër. Njësoj siç përmendim emrin e tij, themi bismil’lah dhe shprehim falënderim kur përfitojmë nga mirësitë e tjera të Allahut, edhe përpara gjumit që na ka dhuruar, duhet të themi bismil’lah. Kështu, në krevatin nga i cili në mëngjes jemi zgjuar me bismil’lah, shtrihemi sërish duke thënë bismil’lah; ashtu si Pejgamberi ynë, edhe ne na zë gjumi duke thënë: “Allahu im, unë fle me emrin Tënd dhe zgjohem me emrin Tënd.”



*Lutjuni Zotit tuaj
përrulshëm dhe
ngadalë! Në të vërtetë,
Ai nuk i do ata që e
kalojnë kufirin.*

(Araf, 7/55)



Porta e hapur drejt pafundësisë: Surja Fatiha

Fatiha do të thotë hapje dhe fillim. Surja e parë që shohim kur hapim Kur’anin e Madhërueshëm, është Surja Fatiha. Ajo është ajka dhe përmbledhja e Kur’anit të Madhërueshëm, duaja më e madhe dhe përgjërimi më i madh i drejtuar ndaj Allahut. Gjithmonë mund të bëjmë dua duke kënduar suren Fatiha. E këndojmë suren Fatiha pasi këndojmë Kur’anin e Madhërueshëm, pas duave, ndaj të vdekurve dhe në çdo rekat të namazeve tona. Ndërsa në fund të sures themi “amin”, në kuptimin “Pranoje, Allahu im.”



Surja Fatiha ajet për ajet

“Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit! Çdo lavdërim i përket Allahut, Zotit të botëve, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit, Sunduesit të Ditës së Gjykimit. Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë. Na udhëzo në rrugën e drejtë! Në rrugën e atyre që u ke dhuruar mirësi e jo në të atyre që kanë shkaktuar zemërimin Tënd, as në të atyre që janë të humbur!”

Allahu krijoi gjithësinë, krijoi të gjitha gjallesat, planetët, yjet, diellin dhe hënën.

*Çdo punë që fillohet
pa bismil'lah,
nuk ka begati.*

(Bejhaki, Sunen, III/209)



Ai është krijuesi i të gjitha gjallesave, atyre që njohim dhe që nuk njohim, që i shohim me sy të lirë apo jo. Ndërsa krijesat i ka krijuar në formën më të bukur.

Allahu i ka ngarkuar një detyrë çdo gjëje që ka krijuar, ka kërkuar edhe që ata ta plotësojnë në formën më të mirë detyrën që u është dhënë dhe i ka edukuar me emrin Rab. Për shembull, nëse një foshnjë do të mbetet njësoj si ditën e parë kur lind, nuk do të mund të fliste, të qeshte, të ecte dhe të rritej. Ai që ia mëson foshnjës të gjitha këto është Allahu. Ai që e mëson zogun të fluturojë, krimbin e mëndafshit të thurë, bletën të bëjë mjaltë, botën të rrotullohet rreth diellit, është Allahu.

Çdo gjë, me gjuhën e saj, falënderon Allahun, që është zot i të gjitha botëve dhe shpreh madhërime ndaj tij. Kështu edhe njeriu, si më i bukuri i krijesave, duhet ta përmendë Zotin në formën më të bukur.

Allahu është rahman (i mëshirshëm). Mëshira e Tij ka përfshirë çdo gjë, Ai dëshiron mirësi, mëshirë dhe bukuri për të gjitha krijesat, dhuron mirësi të pafund, pa bërë dallim ndërmjet atij që do dhe atij që nuk do.

Allahu është rahim (mëshirëbërës). Mëshira e tij përqafton vetëm besimtarët në ahiret, vlerëson duke dhuruar mirësi më të mëdha dhe të pafund ndaj atyre që i përdorin më mirë mirësitë e dhëna.

Allahu është Ai që krijon si jetën, ashtu edhe vdekjen. Çdo krijesë e gjallë vjen në këtë botë, jeton dhe vdes. Stinët që transformohen nga pranvera në dimër, pothuajse na tregojnë rrjedhën e jetës. Sipërfaqja e tokës, e cila është krejtësisht e gjelbër në pranverë, gjatë dimrit pothuajse bie në gjumë, nën një mbulesë krejt të bardhë, tamam si një qefin.

Edhe njeriu, ashtu si çdo gjallesë, një ditë do të vdesë. Mirëpo vdekja nuk është zhdukje, por është fillimi i një jete të re dhe të ndryshme.



Vdekja që na i mbyll sytë për këtë botë, na i hap ata në një jetë tjetër, në jetën e ahiretit. Atje, së pari do të bëhet gjykimi i çdo gjëje. Gabimet dhe sevapet që kemi kryer në botë, na dalin përballë me një dëftesë e regjistër, ku janë të shënuara notat tona.

Jeta e botës është një përgatitje për ahiretin. Veprat që kryejmë në këtë botë dhe në ahiret do të ndriçojnë udhën tonë, ose do ta errësojnë atë. Ja, pra, ajo ditë ku çdokush do të gjykohet, është dita ku do të takohemi me zotin e botëve, Allahun.

Zoti ynë e bën të ditur kështu synimin e krijimit: “Xhindet dhe njerëzit i kam krijuar vetëm që të Më adhurojnë.” (Dharijat, 51/56) Edhe ne e adhurojmë Allahun, hapim duart drejt Tij e përgjrohemi në mënyrë që të plotësojmë domosdoshmërinë e krijimit tonë dhe që të gjejmë prehje.

Allahu nuk do që robi i tij të gjendet në situatë të vështirë dhe të ketë probleme. Ngaqë bota është vend sprove, herë pas here përballemi me vështirësi. Në kohë të tilla hapim duart ndaj Zotit dhe ai na ndihmon. Sepse Allahu është gjithmonë ndihmues ndaj njerëzve që i besojnë dhe që mbështeten tek Ai.

Allahu dërgoi peygamberë dhe libra, në mënyrë që t’i orientojë njerëzit në rrugë të drejtë. Ndërsa detyra që bie mbi ne është të marrim shembull Peygamberin e fundit, Hz. Muhammedin (s.a.s.) dhe të lexojmë Kur’anin e Madhërueshëm që iu dërgua atij. Vetëm në këtë mënyrë mund të jemi në udhën e drejtë që është përcaktuar në ajet.

Ata, ndaj të cilëve është dhuruar mirësi, e falënderojnë Allahun për këto mirësi dhe plotësojnë domosdoshmërinë e kësaj mirësie. Peygamberët dhe dëshmorët janë njerëz të bukur, ata janë bërë shembuj me sjelljet dhe me veprat e mira që kanë praktikuar.

*Allahut i përkasin
emrat më të bukur,
andaj thirreni Atë
(lutjuni Atij) me to.*
(Araf, 7/180)





*O Allah, kërkoj nga
Ti të të dua Ty, të dua
ata që do Ti dhe të
kryej vepra që do të
më çojnë te dashuria
jote. O Allahu im,
bëje dashurinë Tënde
më të dashur për mua
sesa neftin tim, sesa
familjen time
dhe ujin e ftohtë.*
(Tirmidhi, Dua, 73)



Ata që kanë pësuar zemërimin e Allahut, nuk ua vënë veshin urdhëresave dhe ndalesave të tij, nuk mendojnë mbi mirësitë që Ai ka dhuruar, nuk falënderojnë për këto mirësi. Për më tepër, nuk ndiejnë pendesë dhe nuk kërkojnë as falje nga Allahu. Ja, pra, ata, për shkak të mosmirënjohjes së tyre, kanë marrë mbi vete zemërimin e Allahut dhe kanë devijuar nga udha e drejtë. Edhe ne, duke treguar kujdes me sjelljet tona, që të mos jemi si ata, bëjmë dua ndaj Allahut duke thënë: “Në rrugën e atyre që u ke dhuruar mirësi e jo në të atyre që kanë shkaktuar zemërimin Tënd, as në të atyre që janë të humbur!”

Duaja me anë të Esma-i Husna (Emrat e Bukur të Allahut)

Duaja, përveç transmetimit të dëshirave dhe nevojave ndaj Allahut, është një mënyrë edhe për përmendjen dhe madhërimin e Tij. “Allahut i përkasin emrat më të bukur, andaj thirrreni Atë (lutjuni Atij) me to. (Araf, 7/180) Në Kur’an, në veçanti në duatë e Pejgamberit, Zoti ynë madhërohet bashkë me emrat e Tij.

Pejgamberi ynë i dashur, në një hadith të tij lajmëron se Allahu i Lartmadhëruar ka 99 emra, se ai që beson në këto emra dhe që sillet në përputhje me këtë besim, do të hyjë në xhennet. Pa dyshim që emrat e Allahut nuk janë të kufizuar me numrin 99. Përmendja e numrit 99 në hadith nuk vjen në kuptimin e kufizimit, por nënkupton emrat më të njohur të Allahut.

Ndërkohë, kur bëjmë dua, mund të përdorim edhe këto emra të Allahut. Me anë të emrit Rahman mund të kërkojmë që të tregojë mëshirë ndaj nesh, me emrin Rezzak të na japë begati në riskun (racionin e jetës) tonë, me emrin Teuub të pranojë pendimet tona, ndërsa me emrin Uehud të na dojë neve dhe të bëjë që të na duan.



Duaja më e madhe: Ajeti Kursi

*(Ata thonë:) “O Zoti ynë! Mos lejo që zemrat tona të shmangen (nga e vërteta), pasi na ke udhëzuar në rrugën e drejtë, dhe na jep mëshirë prej Teje; vërtet, Ti je Dhuruesi i Madh!
(Al-i Imran, 3/8)*



Pejgamberi ynë i dashur urdhëron: “Çdo gjë ka një kulm dhe thelb. Kulmi dhe thelbi i Kur’anit është surja Bakara. Në të gjendet një ajet, që është më kryesori i ajeteve të Kur’anit. Ai është ajeti Kursi.” (Tirmidhi, Seuabu’l-Kur’an, 2)

Kuptimi i ajetit Kursi është si më poshtë:

“Allahu! Nuk ka zot tjetër (që meriton adhurimin) përveç Tij, të Gjallit, të Përvetshmit, Mbajtësit të gjithçkaje! Atë nuk e kaplon as dremitja, as gjumi! Atij i përket gjithçka që gjendet në qiej dhe gjithçka që gjendet në Tokë. Kush mund të ndërhyjë tek Ai për ndokënd pa lejen e Tij? Ai di çdo gjë që ka ndodhur përpara dhe çdo gjë që do të ndodhë pas njerëzve, kurse ata nuk mund të përvetësojnë asgjë nga Dituria e Tij, përveçse aq sa Ai dëshiron. Kursiu i Tij shtrihet mbi qiejt dhe tokën dhe Ai nuk e ka të vështirë t’i ruajë ato. Ai është i Larti, Madhështori!” (Bakara, 2/255)

Në Ajetin Kursi jepen të dhëna mbi lartësinë, atributet dhe cilësitë e Allahut, mbi faktin se të gjitha ndodhitë në gjithësi janë në përputhje me vullnetin e Tij, se pa qenë dëshira dhe leja e Tij, askush nuk do të mund të hyjë ndërmjetës për dikë tjetër, se ata që janë në qiej dhe në tokë i përkasin Atij.

Bashkë me ajetin Kursi, mësojmë se emri Allah është një emër i posaçëm, që i përket vetëm Zotit tonë. Sado emra dhe veçori që na prezantojnë, ne Allahun kemi, çdo gjë që tregojnë këta i tregon më vete emri Allah.

Gjënë e parë që duhet të dimë për Allahun na e mëson ajeti Kursi: “La ilahe il’allah.” Kjo është “fjala e teuhidit”. Kuptimi i saj është: “Allahu është një, nuk ka shok dhe të ngjashëm me të. Nuk ka Zot tjetër përveç Tij.”

Ai është hajj dhe kajjum. Me emrin hajj i fal jetë e gjallëri çdo gjëje. Sepse Ai zotëron jetën. Çdo gjë ka një fund, ndërsa Allahu është i pafund. Çdo gjallesë vdes, por Allahu është i pavdekshëm. Me anë të emrit Kajjum mbron dhe kujdeset për gjallesat. Çdo gjë ka nevojë për Allahun që të ekzistojë. Ndërsa Allahu nuk ka nevojë për askënd. Çdo gjë e vijon ekzistencën bashkë me përkujdesjen e tij.

Allahu di çdo gjë që kemi kryer dhe që do të kryejmë. Asgjë nuk i mbetet e fshehtë Atij. Ai është Alim (i Ditur). Zotëron cilësinë e të diturit të çdo gjëje. Edhe ato që ëndërrojmë dhe imagjinojmë nuk janë të fshehta për Allahun. Ndërsa ne mund të mësojmë aq sa Ai dëshiron. Kursia e Tij ka kapluar çdo gjë që është në qiej dhe në tokë; çdo gjë është nën urdhrin e Tij. Sepse Ai është mjaft i lartë dhe i madh.

Dhurata e ardhur nga Miraxhi: ajetet e fundit të sures Bakara


Këto ajete, të cilat i njohim edhe si Amene'r-Rasulu, janë ajetet 285 dhe 286 të sures Bakara, të cilat i zbritën Pejgamberit tonë të dashur gjatë ngjarjes së Miraxhit. Ndërsa duaja në fund të këtyre ajeteve është si më poshtë:

“Zoti ynë, mos na ndëshko për atë që harrojmë ose e bëjmë pa qëllim! Zoti ynë, mos na ngarko barrë të rëndë, ashtu siç ua ngarkove atyre para nesh! Zoti ynë, mos na ngarko me diçka që nuk mund ta mbajmë! Na i shlyej gjynahet tona, na i fal ato dhe na mëshiro! Ti je Zoti Ynë! Prandaj, na jep fitore kundër atyre që nuk besojnë!”



Zoti ynë! Me të vërtetë kemi besuar, andaj na i fal gjynahet tona dhe na ruaj nga dënimi i zjarrit!

(Al-i Imran, 3/16)





Duatë Rabbena

Në fund të pesë kohëve të namazit që falim gjatë ditës, lexojmë duatë Rabbena. Në këto dua themi kështu: “Zoti ynë, na jep të mira në këtë botë, na jep të mira në botën tjetër dhe na ruaj nga dënimi i zjarrit (të xhehennemit)” (Bakara, 2/201)

“O Zoti ynë, më fal mua, prindërit e mi dhe besimtarët, në Ditën kur do të jepet llogari!” (Ibrahim, 41/14)



“O Zoti im, mëshiroji ata (nënë dhe babanë), ashtu siç më kanë rritur, kur unë isha i vogël!”

(Isra, 17/24)



Suret Ihlas, Felek dhe Nas si dua

Suret Ihlas, Felek dhe Nas i këndojmë edhe si dua. Kuptimi i këtyre sureve është si më poshtë:

“Thuaj: ‘Ai është Allahu, Një dhe i Vetëm! Allahu është Absoluti, të Cilit i përgjërohet gjithçka në amshim. Ai as nuk lind, as nuk është i lindur. Dhe askush nuk është i barabartë (a i krahasueshëm) me Atë!’”

“Thuaj: ‘Kërkoj mbështetje te Zoti i agimit, që të më mbrojë nga sherri i gjithçkaje që Ai ka krijuar, nga sherri i natës, kur kaplon terri, nga sherri i falltarëve që fryjnë në nyje (duke bërë magji) dhe nga sherri i smirëziut, kur vepron me smirë.’”

“Thuaj: ‘Kërkoj mbështetje te Zoti i njerëzve, Sundimtari i njerëzve, i Adhuruari (i vetëm me të drejtë) i njerëzve, nga sherri i djallit cytës që fshihet (pasi cyt) e që hedh dyshime në zemrat e njerëzve, (qoftë ai djall) prej xhindeve apo njerëzve!’”



Lutjet që këndohen në namaz

Duaja Subhaneke

Allahu ynë, i madh je dhe i lavdëruar! Emri Yt është i bekuar, qenia Jote është mbi gjithçka, nuk ka Zot tjetër përveç Teje!

Duaja Ettehijatu

*“O Zoti ynë, falna
neve dhe vëllezërit
tanë, të cilët kanë
besuar para nesh;
mos lejo që në
zemrat tona të
ketë asnjë të keqe
ndaj besimtarëve!
O Zoti ynë, Ti je
vërtet i Butë dhe
Mëshirëplotë!”*

(Hashr, 59/10)

Të gjitha adhurimet e kryera me gjuhë, trup dhe me pasuri, i drejtohen Allahut. Të gjitha adhurimet i takojnë Allahut! Mëshira, paqja, bekimi dhe shpëtimi qofshin mbi ty dhe mbi të gjithë robërit e mirë, o i Dërguari i Allahut! Dëshmoj se s’ka Zot tjetër përveç Allahut dhe Muhammedi është robi dhe i dërguari i Tij!

Duatë Sal’li dhe Barik

Allahu ynë, mëshiroje Muhammedin dhe familjen e tij, siç e mëshirove Ibrahimin dhe familjen e tij! Pa dyshim, Ti je i madh dhe i denjë për lavdërim!

Allahu ynë, bekoje Muhammedin dhe familjen e tij, siç e bekoje Ibrahimin dhe familjen e tij! Pa dyshim, Ti je i madh dhe i denjë për lavdërim!

Duatë Kunut

Allahu ynë, prej Teje kërkojmë ndihmë, prej Teje kërkojmë të na falësh dhe prej Teje kërkojmë të na udhëzosh! Ty të besojmë dhe Ty të shfaqim pendimin tonë! Te Ti mbështetemi dhe Ty të lavdërojmë për të mirat që na ke falur! Ne nuk i mohojmë të mirat e Tua dhe heqim dorë prej atij që të kundërshton e të mohon Ty!

Allahu ynë, vetëm Ty të adhurojmë, namazin vetëm për Ty e falim dhe vetëm para teje biem në sexhde! Vetëm te Ti vrapojmë dhe vetëm Ty të adhurojmë! I frikësohemi ndëshkimit Tënd dhe shpresojmë në mëshirën Tënde! Pa dyshim, ndëshkimi Yt do t’i kapë mosbesimtarët!



Lutjet e Pejgamberëve që ndriçojnë rrugën tonë

Pejgamberët, të cilët u dërguan te njerëzit që t'u shpjegojnë rrugën e drejtë, janë bërë shembull për njerëzit edhe nga pikëpamja e lutjeve. Edhe ne mund t'i mësojmë përmendësh këto dua dhe mund t'i bëjmë dua Zotit tonë ashtu siç bënin pejgamberët.

Duaja e Hz. Ademit dhe Havasë

Kur Ademi dhe Havaja u dërguan në tokë, ato derdhën shumë lot për shkak të gabimeve të tyre dhe bënë dua kështu: “O Zoti ynë! Ne e kemi futur veten në gjynah, prandaj, nëse Ti nuk na fal dhe nuk na mëshiron, ne vërtet që do të jemi nga të humburit.” (A'raf, 7/23)

Duaja e Hz. Nuhut

“O Zoti im! Unë jam i mundur, andaj më ndihmo!” (Kamer, 54/10)
“O Zoti im, mbështetem tek Ti që të mos kërkoj gjëra, për të cilat nuk kam dijeni. Nëse Ti nuk më fal dhe nuk më mëshiron, do të jem nga të humburit”. (Hud, 11/47)

Duaja e Hz. Ibrahimit

Qabenë, të cilën në ditët e sotme e vizitojnë miliona njerëz, me qëllim që të plotësojnë adhurimin e haxhit dhe umres, Hz. Ibrahimit dhe djali i tij, Hz. Ismaili, e kanë ndërtuar mijëra vjet më parë në drejtim të shpalljes hyjnore të ardhur nga Allahu dhe më pas kanë bërë dua kështu:



O Zoti ynë, tek Ti mbështetemi, Ty të drejtohem dhe tek Ti do të kthehem. O Zoti ynë, mos na bëj sprovë për jobsimtarët dhe na fal ne, o Zot. Vërtet, Ti je i Plotfuqishmi dhe i Urti.

(Mumtehine, 60/4-5)





“O Zoti ynë! Pranoje prej nesh (këtë vepër)! Me të vërtetë, Ti je Ai që dëgjon dhe di gjithçka! (Bakara, 2/127)

Hz. Ibrahim ka edhe dua të tjera, ku është shprehur:

“O Zoti ynë! Na bëj të përlulur ndaj Teje! Bëj që edhe pasardhësit tanë të jenë të përlulur ndaj Teje! Na trego ritet e haxhit dhe pranoje pendimin tonë; pa dyshim, Ti je Pranuesi i pendimit, Mëshirëploti!”

“O Zoti ynë! Dërgo tek ata një të dërguar nga gjiri i tyre, që t’u lexojë shpalljet e Tua, t’ua mësojë Librin dhe Urtësinë (rregullat e fesë) e t’i pastrojë (nga gjynahet)! Vërtet, Ti je i Plotfuqishmi dhe i Urti!”

“O Zoti ynë, unë kam vendosur disa nga pasardhësit e mi në një luginë që nuk mbillet, afër Shtëpisë Tënde të Shenjtë, që të falin namazin. Prandaj, bëj që zemrat e njerëzve të ndiejnë dashamirësi për ata dhe jepu fruta, me qëllim që ata të të falënderojnë.”

“O Zoti ynë, Ti e di vërtet çfarë fshehim e çfarë shfaqim haptazi. Allahut nuk i fshihet asgjë, as në tokë, as në qiell. Qoftë i lavdëruar Allahu, i cili në pleqëri më dhuroi Ismailin dhe Is’hakun! Vërtet, Zoti im i dëgjon lutjet!”

“O Zoti im, bëj që unë dhe pasardhësit e mi ta kryejmë përherë namazin! O Zoti ynë, na i prano lutjet!

“O Zoti ynë, më fal mua, prindërit e mi dhe besimtarët, në Ditën kur do të jepet llogari!”

“O Zoti im, më dhuro dituri dhe më radhit ndër të mirët! Bëj që të përmendem për të mirë te breznitë e ardhshme dhe më bëj një nga trashëgimtarët e xhennetit të begatë! Fale babanë tim, sepse ai është njëri nga të humburit.” (Shuara, 86-83/26)



Duaja e Hz. Lutit

Hz. Lut, që në Kur'anin e Madhërueshëm citohet si një peygamber, ndaj të cilit ishte dhënë dispozitë fetare dhe dije, e ka shpjeguar për vite të tëra fenë e vërtetë. Mirëpo, kur populli i Hz. Lutit këmbënguli në gjynah dhe e sfidoi hapur atë, bëri dua ndaj Allahut duke thënë: “O Zoti im, më shpëto mua dhe familjen time nga ajo që bëjnë ata!” (Shuara, 26/169) dhe: “O Zoti im, më ndihmo kundër popullit që bën mbrapshti!” (Rum, 30/30) Allahu e pranoi këtë dua dhe populli që u rebelua ndaj të dërguarit të Allahut u zhduk.

Duaja e Hz. Jakubit

“Dhimbjen time dhe pikëllimin tim ia paraqes vetëm Allahut, nga Allahu di atë që nuk e dini ju”. (Jusuf, 12/86)

Duaja e Hz. Jusufit

Surja Jusuf është një sure ku tregohen ngjarjet që i ndodhën Hz. Jusufit. Në këtë sure tregohet në mënyrë të hollësishme ëndrra që sheh Hz. Jusufi, hedhja e tij në pus nga vëllezërit, shpëtimi i tij nga një karvan që po kalonte andej, shitja e tij si shërbëtor te veziri i Egjiptit, rënia në dashuri me të e bashkëshortes së vezirit, futja në burg, komentimi i ëndrrës së sovranit të Egjiptit, rënia e zisë dhe përballja e tij me vëllezërit, falja e tyre, më pas takimi me babanë e vet. Prandaj, në tregimin e Hz. Jusufit ka shembuj të bukur.

“O Zoti im! Ti më ke dhënë pushtet dhe më ke mësuar shpjegimin e ëndrrave! O Krijues i qiejve dhe i tokës, Ti je Mbrojtësi im, edhe në këtë botë, edhe në botën tjetër! Bëj që të vdes si musliman dhe më shoqëro me ata që bëjnë punë të mira (në botën tjetër)!” (Jusuf, 12/101)





Duaja e Hz. Ejubit

Hz. Ejubi vuante nga një sëmundje e pashërueshme. Për një kohë të gjatë kaloi vështirësi të mëdha, por duke rezistuar ndaj këtyre vështirësive, u bë shembull për të gjithë besimtarët. Edhe ne, cilado qoftë mënyra dhe kohëzgjatja e sprovës me të cilën përballemi, duhet të tregojmë durim kundrejt vështirësive, nuk duhet të rebelohemi dhe nuk duhet t'i humbim shpresat ndaj Allahut; duhet të dimë se rezultati i durimit do të jetë i bukur. “Mua më ka goditur fatkeqësia e Ti je më mëshiruesi i mëshiruesve!” (Enbija, 21/83)



Duaja e Hz. Shuajbit

Hz. Shuajbi, i cili u dërgua si Pejgamber ndaj popullit Medjen dhe Ejke, u kërcënua me syrgjynosje në tokat ku jetonte bashkë me besimtarët e tjerë, të cilët i besuan atij. Pas kësaj bëri dua ndaj Allahut duke shprehur nënshtrim:

“Nëse do të ktheheshim në fenë tuaj, pasi Allahu na shpëtoi prej saj, atëherë do të shpifnim gënjeshtër kundër Allahut. Ne nuk mund të kthehemi tek ajo fe, përveçse po të dojë Allahu, Zoti ynë. Ai përfshin çdo gjë me dijeninë e Vet dhe tek Ai mbështetemi. O Zoti ynë, gjyko drejt midis nesh dhe popullit tonë! Ti je Gjykatësi më i mirë”! (A'raf, 7/89)



Duaja e Hz. Musait

“O Zot! Më fal mua dhe vëllanë tim, na prano në mëshirën Tënde! Ti je më i Mëshirshmi i mëshiruesve”. (Araf, 7/151)

“Na cakto të mira në këtë botë dhe në tjetrën, sepse veç tek Ti kthehem.” (Araf, 7/156)

“O Zoti im, zgjeroma kraharorin tim, lehtësoma punën time dhe zgjidhma nyjën e gjuhës sime, që ata ta kuptojnë fjalën time!” (Ta-Ha, 20/25-28)

Duaja e Hz. Sulejmanit

“O Zoti im, më fal dhe më dhuro një pushtet, që të mos e ketë askush pas meje! Me të vërtetë, Ti je Dhurues i madh!” (Sad, 38/35)

“O Zoti im, më frymëzo të të jem mirënjohës për mirësitë që më ke dhënë mua dhe prindërve të mi, më frymëzo të bëj vepra të mira, me të cilat Ti do të jesh i kënaqur.” (Neml, 27/19)

Duaja e Hz. Junus

“S’ka Zot tjetër, përveç Teje! Qofsh i lavdëruar! Me të vërtetë, unë kam gabuar!” “Ne iu përgjigjëm atij dhe e shpëtuan nga brengosja. Kështu, Ne i shpëtojmë besimtarët.” (Enbija, 21/87-88)



Duaja e Hz. Zekerijas

Hz. Zekerija, i cili ishte në moshë të thyer, ndërsa bashkëshortja ishte sterile (që nuk bënte fëmijë), kërkoi nga Allahu një fëmijë që të mund ta mbante më këmbë besimin pas atij.

“Kur ai e thirri Zotin e vet me lutje të fshehtë (duke thënë): ‘O Zoti im! Eshtrat tashmë më janë dobësuar, koka më shndrin nga thinjat dhe asnjëherë nuk kam mbetur i zhgënjyer nga lutja ime për Ty, o Zoti im! Unë u frikësohem (sjelljeve të) të afërmeve të mi pas meje, ndërsa bashkëshortja ime është beronjë (sterile); andaj, më dhuro nga ana Jote një pasardhës, që të më trashëgojë mua dhe familjen e Jakubit. O Zoti im, bëje atë të pëlqyeshëm (për Ty)!” (Merjem, 19/3-6)

“Ne iu përgjigjëm atij dhe i dhuruam Jahjain, duke ia bërë gruan të aftë (për lindje). Me të vërtetë, ata nxitonin për vepra të mira dhe Na luteshin, me shpresë e frikë dhe ishin të përlulur ndaj Nesh.” (Enbija, 21/90)



Duaja e Hz. Isait

“Pastaj, Allahu do të thotë (në Ditën e Gjykimit): ‘O Isa, i biri i Merjemes! Ti ishe ai që u the njerëzve: ‘Adhuromeni mua dhe nënën time si zota krahas Allahut?! Isai do të thotë: ‘Qofsh i lartësuar dhe i lavdëruar! Mua nuk më takon të them diçka, për të cilën nuk kam aspak të drejtë! Po ta kisha thënë ndonjëherë, Ti me siguri do ta dije. Ti e di çfarë ka në shpirtin tim, po unë nuk e di çfarë ka në Vetën Tënde. Vetëm Ti i di të gjitha të fshehtat. Unë nuk u kam thënë asgjë tjetër, përveç asaj që më ke urdhëruar Ti: ‘Adhuroni Allahun, Zotin tim dhe Zotin tuaj! Kam qenë dëshmitar, për sa kohë që kam jetuar midis tyre dhe, qëkurse më more mua, vetëm Ti ishe mbikëqyrës i tyre. Ti je Dëshmitar për çdo gjë. Nëse Ti i dënon ata - robërit e Tu janë, e nëse i fal ata, me të vërtetë, vetëm Ti je i Plotfuqishmi dhe i Urti.’” (Maide, 5/116-118)

Disa dua të Hz. Muhammedit (s.a.s.) që citohen në Kur'anin e Madhërueshëm

Të gjitha duatë që i përkasin Pejgamberit tonë të dashur dhe që citohen në Kur'an, fillojnë në formën “thuj që” ose “thuj”.

Zoti ynë e ka mësuar edhe Pejgamberin tonë se si të bëjë dua:

“Dhe thuj: ‘O Zoti im, kërkuj të më mbrosh nga nxitjet e shejtanëve, dhe tek Ti mbështetem, o Zoti im, që të mos i kem pranë meje.’” (Mu'minun, 23/97-98)

“Thuj: ‘O Zoti im, më shpjer në një hyrje në gjendje të kënaqur, më nxirr nga një dalje në gjendje të kënaqur dhe më dhuro nga Ti fuqi, që do të më ndihmojë!’” (Isra, 17/80)

“Thuj: ‘O Zoti im, shtoma dijen!’” (Ta-Ha, 20/114)

“Dhe thuj (o Muhammed!): ‘O Zoti im, fal dhe mëshiro, se Ti je më i miri i mëshiruesve!’” (Mu'minun, 23/118)



Edhe disa dua nga jeta e Pejgamberit tonë

Pejgamberi ynë, njësoj si në jetën adhurimore, ashtu edhe në jetën e përditshme, gjithmonë i hapte duart në çastet e pikëlluara dhe të gëzuara, i drejtohej Allahut; i përgjërohej gjithmonë atij:

“Allahu im, ta dorëzova ty nefsin tim. E ktheva fytyrën nga Ti. E lashë në dorën tënde punën time. E mbështeta shpinën tek Ti, duke shpresuar në kënaqësinë tënde, duke u frikësuar nga zemërimi Yt. U mbështeta tek Ti. Nuk ka strehë dhe mbështetje tjetër pos Teje. Allahu im, besova në librin që zbritte, në Pejgamberin që dërgove.” (Buhari, Deavat, 7)

“Allahu im, kërkuj nga ti të mundësosh që të të dua, të dua ata që do ti dhe të kryej vepra që do të më udhëzojnë drejt dashurisë tënde. Allahu im, bëje dashurinë tënde më të dashur për mua se nefsi im, se familja ime dhe uji i ftohtë.” (Tirmidhi, Dua, 73)

“Allahu im, na jep gjëra të mira në botë dhe në ahiret.”
(Muslim, Dhikr, 26)

“Allahu im, më fal mua, më mëshiro mua, më mundëso të bëj vepra që të fitoj kënaqësinë tënde, më dhuro mua mirësi dhe risk të hairit.” (Muslim, Dhikr, 35)

“Allahu im, më oriento në udhë të drejtë dhe më bëj të suksesshëm në atë rrugë.” (Muslim, Dhikr, 78)

“Allahu im, mbështetem tek Ti nga të qenit me moral të keq, nga kryerja e veprave të këqija dhe nga devijimi në besime të gabuara.” (Tirmidhi, Dua, 126)

“Allahu im, mbështetem tek Ti nga zhdukja e mirësive që më ke dhënë, nga çrregullimi i shëndetit që më ke falur, nga dënimi i papritur që mund të më japësh dhe nga tërheqja mbi vete e dënimit tënd.” (Muslim, Dhikr, 96)

“Allahu im, mbështetem tek Ti nga dembelizmi, nga të qenit frikacak, nga pleqëria, nga dënimi i varrit, nga përçarja e të gjallëve dhe të vdekurve.” (Muslim, Dhikr, 50)

“Allahu im! Mbështetem tek Ti nga dija që nuk jep dobi, nga zemra që nuk drithërohet, nga nefsi i pangopur, nga duaja e papranuar.” (Muslim, Dhikr, 73)

“Allahu im! Kërkoj udhëzim në rrugë të drejtë nga Ti, devotshmëri, pasuri dëlirësie dhe zemre.” (Muslim, Dhikr, 72)

“O Zoti im! Më bëj mua ndër ata që gëzohen kur bëjnë mirësi, nga ata që ndiejnë pendesë kur bëjnë të këqija.” (Ibn Maxhe, Edeb, 57)



Dua nga figura të njohura islame

“Allahu im! Kërkoj prej Teje të gjitha të mirat dhe të bukurat. Mbështetem tek Ti nga të gjitha të këqijat dhe të shëmtuarat” (Aishe r.anh.)

“Allahu im! Më mundëso të kryej vepra të mira. Bëji ato të posaçme për kënaqësinë tënde. Shmangi ato nga dukja dhe gënjeshtra brenda tyre.” (Omer r.a.)

“O Krijues! Ti e sheh gjendjen time, e di pamundësinë time. E dëgjon përgjërimin tim të fshehtë. Mos më shto mua ndër radhët e atyre që kanë humbur shpresë nga Ti, mos i vër re të metat e mia, mos më lër të pres më shumë, mos më hidh në pesimizëm. Besoj plotësisht në mëshirën tënde. Ndize zjarrin e dashurisë në zemrën time, më ngop mua me dashurinë tënde, mos e pakëso dashurinë tënde ndaj meje. U përkula para madhësisë tënde, rashë në sexhde, më fal mua.” (Hz. Ali)

“Falënderimet qofshin për Allahun, i cili nuk e harron atë që e përkujton. Falënderimet qofshin për Allahun, i cili nuk e kthen duarbosh atë që bën dua, nuk bën të qajë atë që i përgjërohet dhe nuk e zhgënjen atë që shpreson.” (Hz. Hasan)



“Kërkoj mbrojtje dhe mbështetje prej Teje nga uria dhe tradhtia, që janë shokët më të lig. Kërkoj mbrojtje dhe mbështetje prej Teje nga dembelizmi, koprracia, frika dhe pleqëria e theksuar. Kërkoj mbrojtje dhe mbështetje nga Ti prej përçarjes dhe grindjes së jetës dhe vdekjes.” (Imam Gazzali)

“Allahu im! Ma pastro brendësinë, që të mos jetë vendbanim për dashurinë e dikujt tjetër, pos dashurisë ndaj teje.” (Abdulkadir Gejlani)

“Allahu im! Duaja të drejtohet Ty, pranimi dhe miratimi i asaj duaje varet sërish nga Ti! Nëse kemi gabuar me fjalë të padenja për Ty në dua dhe përgjërime, pastroji e rregulloji ato fjalë dhe pranoji. Sepse Ti je zotëruesi i të gjitha fjalëve.”

“Zoti im! Unë e pastrova trupin tim nga ndyrësitë. Pastroje edhe Ti brendësinë time nga të këqijat, bëje të dëlirë atë.” (Mevlana)

“O Zot! Ne nuk pranojmë zotësinë e dikujt tjetër, përveç zotësisë tënde dhe të nënshtrohemi vetëm Ty. Vetëm duke t’u bindur Ty gjejmë paqen e brendshme dhe qetësi në zemër. Sepse burimi i parë dhe i fundit i të gjithë frikërave e shpresave je vetëm Ti. Nuk ka frikë nëse Ti nuk e jep atë. Nuk ka shpresë nëse Ti nuk e jep atë. Po nuk fale shije Ti, çdo gjë është e hidhur; nëse Ti nuk fal hidhërim, çdo gjë është e shijshme.” (Muhammed Hamdi Yazır)





Le të lexojmë: FJALA BISMIL'LAH

Allah është fjala jonë e parë,
me besim është e mbushur
brendia jonë.

Punët, ashtu si nisin me
emrin e Allahut,
po me emrin e Allahut mbarojnë.

Kur zgjohem çdo mëngjes,
menjëherë bismil'lah them!

Kur ha apo pi diçka,
kur hap librin tim...

gjithmonë bismil'lah them,
madje nuk harroj asnjëherë.

I drejtohem Zotit tim,
vjen forcë e fuqi në zemrën time.

Bashkë me Allahun, vështirësitë,
të pakta a të shumta qofshin,
gjithnjë zhduken.

Ai që thotë bismil'lah,
suksesin përqafton.

Kurrë nuk e lë pa thënë,
kështu Allahu për dore më mban.

Mustafa Asım Köksal







KUR SHTRIHEM

U shtriva në të djathtë,
u ktheva në të majtë,
Allahut iu mbështeta,
melekët qofshin dëshmitarët e mi
për fenë time, për besimin tim.

Rashë në gjumë, Allahu im,
më zgjo mua,
më përhumb në nur.
Kur të ndahet shpirti nga trupi,
më ço me besim e iman!





KAPITULLI I TRETË

EDHE TI BËJ DUA

Të falënderosh me dua: Allahu qoftë i kënaqur me ty

Kur përballemi me një mirësi apo me një situatë që na pëlqen, dëshirojmë të falënderojmë atë që ka bërë mirësi, që është sjellë mirë. Sidomos në rastet kur kjo ndihmë na ka ardhur në një kohë të vështirë, falënderimi ynë do të jetë më i përzemërt. Në fakt, është Zoti ynë ai që na ka përballur me atë mirësi. Gjithsesi, duke falënderuar njerëzit, konsiderohet të kemi falënderuar edhe Zotin tonë. Ndërsa kur bëjmë këtë, nga një anë i bëjmë dua Zotit tonë dhe kështu falënderimi ynë zbukurohet më shumë. Ka një mënyrë për realizimin e kësaj, edhe ajo është të themi: “Allahu qoftë i kënaqur me ty!”

Shprehja “Allahu qoftë i kënaqur me ty” mund të përdoret në vend të mjaft fjalive falënderuese. Për shembull: “Allahu ta shpërbleftë me të mira” do të thotë “Nëna ime e dashur, ushqimi qenka bërë shumë i mirë, të lumshin duart!”

Do të thotë: “Babai im i dashur, të falënderoj shumë për të hollat që më dhe.”

Do të thotë: “Shoku im, më lejove të përdor gomën tënde, më shpëtove nga një situatë e vështirë, paç jetën e gjatë!”



Do të thotë: “Faleminderit që i more mbeturinat tona, xhaxhi mirëmbajtës i pallatit.” “Përfundoi loja jonë, sa bukur luajtëm, shokël!” “Mësuesi im, na dhurove dije mjaft të vyera, faleminderit.”

Do të thotë: “Në këmbim të kësaj mirësie që më bëre mua, edhe Allahu të ndihmoftë ty, mos të të lëntë në pozitë të vështirë, i plotëssoftë dëshirat e tua, të dashtë ty!”

Edhe ne themi: “Allahu qoftë i kënaqur me të gjithë ju, fëmijël!” Sepse ju po bëni një punë të mirë: po lexoni.



Kur shtrihemi për të fjetur dhe kur zgjohemi nga gjumi

Bashkë me zgjimin, çdo mëngjes përshëndesim një ditë të re. Dielli lartësohet dalëngadalë në qiell, zogjtë mërmërisin këngët e tyre. Njerëzit lëvizin ashtu si milingonat lart e poshtë në rrugë dhe rrugica.

Kur ngremë kokën nga jastëku dhe zgjohemi në një ditë të re, e gjithë bota tashmë është përgatitur për ne. Ndaj kësaj dite mund të bëjmë një fillim, në mënyrën më të bukur, me dua.

“Allahu im! Falënderimet qofshin për ty, që mundësove të zgjohem në këtë ditë të bukur. Falënderimet qofshin për ty, që i fale shëndet trupit tim. Mbushe me bukuri dhe mirësi këtë ditë. Ashtu siç na përçove në mëngjes me mirësi, na përço edhe në mbrëmje me mirësi.” Me një dua të ngjashme me këtë, ose duke mësuar dhe lexuar një dua që ka kënduar a këshilluar Pejgamberi ynë, mund të hapim portat e një dite të re.





Ashtu siç e fillojmë ditën me dua kur zgjohemi në mëngjes, edhe kur shtrihemi në krevat për të fjetur gjumë, do të jetë mirë ta përfundojmë ditën me dua. Kështu, dita jonë e mbetur mes dy duave do të jetë më e dobishme për ne.

Allahu im! Me ndihmën tënde arritëm mbrëmjen. Mbështetem tek Ti nga të këqijat dhe vështirësitë. Pranoji mirësitë e mia, fali gabimet e mia. Mund të bëjmë dua duke thënë: “Më mundëso një ditë më të bukur se sot, mua dhe të dashurve të mi kur të zgjohemi”, ose mund të bëjmë dua ashtu siç dëshirojmë. Në ditë mund të këndojmë nga tri herë tri suret e fundit të Kur’anit, pra suret Ihlas, Felek dhe Nas, këndimin e të cilave e këshillon Pejgamberi ynë.

Dua që të jenë mburojë ndaj të këqijave

Në këtë botë, herë pas here mund të përballemi me njerëz dashakeqës ose me të këqija të natyrave të ndryshme. Prandaj duhet të jemi të fortë, të mundohemi ta përmirësojmë atë të keqe, të tregojmë durim dhe të kërkojmë ndihmë nga Allahu. Fuqia e Allahut mjafton për çdo gjë. Nëse Ai na mbron, nuk mund të na dëmtojë askush. Atëherë duhet të kërkojmë nga ai që të na ruajë ne dhe të dashurit tanë nga të këqijat dhe nga dashakeqësit. Duhet të shprehim dëshirë që të na përballë me të mirët dhe të besueshmit, që të jemi njerëz të mirë dhe të bëjmë dua në këtë pikë.

Duatë të shpëtojnë nga frika

Ndonjëherë frikësohemi nga diçka që nuk e njohim, ndërsa herë të tjera nga gjëra që i njohim, por që nuk i duam. Kur ndiejmë frikë, shpërqendrohemi, kemi dridhje, djersijmë, madje edhe qajmë. Në fakt, kur qetësohemi kuptojmë se nuk ia vlente të frikësohemi aq shumë. Në vend që të presim largimin e asaj që na tremb, për të shpëtuar nga frika, mund t’i bëjmë dua Allahut dhe të qetësohemi, mund të kërkojmë ndihmën e Allahut, i cili është i aftë për çdo gjë.



E dimë se Zoti ynë sheh dhe dëgjon çdo gjë. Po ashtu, e dimë se sa hidhërohem dhe ndihemi keq kur frikësohemi. Vetëm ai mund ta largojë frikën nga ne dhe vetëm ai mund të na mbrojë nga gjërat, prej të cilave frikësohemi. Është ai që na fal paqe e qetësi në zemrën tonë. Duke shprehur dua ndaj Tij, ne mund të shpëtojmë nga frikërat.

Duatë largojnë mërzitë dhe pikëllimet

Në jetë mund të kemi çaste të hidhëruara dhe të vështira. Allahu, i cili na bën të shqetësohemi për diçka, na jep edhe shërimin apo zgjidhjen. Në situata të tilla duhet të mbështetemi tek Allahu, të bëjmë dua dhe të angazhohemi me vepra që largojnë pikëllimin tonë. Gjithmonë mund të bëjmë dua në mënyrë që të qetësojmë e freskojmë zemrën tonë.

E dimë se Zoti ynë është zotëruesi i qiejve dhe i tokës, se nëse kërkojmë ndihmë nga Ai, do të na ndihmojë, se mund të shpëtojmë nga mërzitë dhe vështirësitë duke i drejtuar dua Atij.

Mund të bëjmë dua duke thënë: “O Krijuesi ynë! Fuqia jote mjafton për çdo gjë. Të përgjerohem në mënyrë që të largohen nga ne mërzitë, pikëllimet dhe vështirësitë. E dimë se e dëgjon zërin tonë, na ndihmo ne.” Mund të këndojmë ajetet e shërimit dhe të duasë, që citohen në Kur’an. Atëherë Zoti do të na ndihmojë dhe do të na mbrojë nga çdo vështirësi.

Duatë largojnë dyshimet

Çdo stinë ka veçoritë dhe karakteristikat e saj. Vera dhe dimri janë krejt të ndryshme nga njëra-tjetra. Për shembull, çdokush prej nesh e di se sa vështirësi hasim kur bie mjegulla dhe nuk arrijmë të shohim njëri-tjetrin. Ndonjëherë nuk arrijmë të vëmë re shtyllën ose gropën që gjendet disa hapa larg nesh. Në fakt, edhe dyshimi është kështu. Kur biem në dyshim, nuk mund të shohim qartësisht përpara nesh.



Në këtë situatë, nuk mund të marrim vendime të sakta dhe mundësia për të gabuar shtohet. Prandaj, në raste të tilla, duhet të mbështetemi patjetër tek Allahu, të kërkojmë ndihmë nga Ai. Duhet të bëjmë dua me qëllim që të shpëtojmë nga dyshimet që na kanë kapluar.

Mund të bëjmë dua duke thënë: “O Zoti im! Më mbro që të mos më brejnë dyshimet nga brenda. Qetësoje zemrën time. Më mbro që të mos humbas mes dyshimeve dhe të mos çekuilibrohem. Më mundëso që në çdo punë të respektoj pëlqimin tënd, të marr vendime të dobishme për të ardhmen time. Më mbro nga pendesat e mëpastajme dhe nga dëmtimi i vetes pa qenë në dijeni”, ose me fjali të tjera të ngjashme me këto.

Duatë këndohen për shërim

Ndryshe nga pjesa më e madhe e ditëve tona, që kalojnë në shëndet të plotë, në disa ditë mund të përballemi me sëmundje. Mund të ndiejmë shumë dhimbje dhe, në varësi të sëmundjes që na ka zënë, mund të kalojmë çaste të vështira. Allahu, që na ka sjellë sëmundjen, patjetër që mund të japë edhe shërimin. Prandaj, edhe kur sëmuremi shkojmë te doktori dhe shpresojmë të shërohemi. Në të njëjtën kohë i drejtojmë dua Allahut që të na falë një zgjidhje dhe shërim, qoftë për sëmundjen, qoftë për vështirësitë që ndiejmë, një zgjidhje për dhimbjet që nuk i dinë njerëzit. Sepse është Ai që jep shërimin e sëmundjeve tona trupore dhe shpirtërore. Duke u nisur nga kjo, kur e ndiejmë veten të dobët, po edhe kur presim që të shërohemi, duhet të bëjmë dua.

Mund të bëjmë dua duke thënë: “Allahu im i Lartësuar! Ti nuk na jep sëmundje që nuk kanë shërim. E krijon edhe shërimin dhe zgjidhjen e çdo problemi. Jepu shërim sëmundjeve të mia. Më mundëso që të shpëtoj nga sëmundja, të njoh vlerën e shëndetit tim.” Po ashtu, mund të këndonit ajetet e shërimit dhe të duasë që citohen në Kur’an e në hadithe.



Kam dëshirat e mia

Dëshirat dhe kërkesat e njeriut nuk njohin verë apo dimër, natë apo ditë, të rritur apo të vogël. Kur plotësohen, gëzohemi; kur realizimi i tyre vonohet, ndiejmë hidhërim në zemër, por në përgjithësi, pa na ndodhur diçka, nuk arrijmë ta vëmë re nëse është e hairit për ne apo jo. Edhe pse Ai i njeh dëshirat tona, sërish dëshiron që ne t'ia shprehim ato. Atij dhe të kërkojmë ndihmë nga Ai. Edhe ne, duke ia shprehur të gjitha nevojat tona, kërkojmë atë që është e hairit për ne. Kur realizohet diçka që dëshirojmë, bëjmë dua për falënderim.

Mund t'i drejtojmë dua Allahut duke thënë: “O Allahu im i Lartësuar! Mos m'i kthe bosh duart që hapen drejt teje. Edhe unë kërkoj ndihmë nga Ti. Bëra çdo gjë që munda dhe tani pres një rezultat të hairit nga Ti. Më bashko mua me dëshirën time. Mbaj larg nga unë ata që hidhërojnë zemrën time, gjërat që më dëmtojnë. Fali dëshirat dhe rezultatet e mia të bukura e të mbara”, ose me fjali të tilla të ngjashme me këto.

Dua për gjyshërit, gjyshet dhe të afërmit

Siç e dini, përveç nënës dhe babait, ka edhe të rritur të tjerë që janë pjesëtarë të familjes sonë. Nuk duhet t'i harrojmë ata në duatë tona, në mënyrë që të jemi fëmijë i hairit, nip i mbarë dhe i afërm i mirë. Pa dyshim që të rriturit tanë kanë të drejta mbi ne. Nëse dëshirojmë që Allahu të jetë i kënaqur nga ne, duhet të sillemi mirë me të rriturit, duhet të tregojmë sjellje që do të kënaqin zemrat e tyre. Duhet të bëjmë dua për ta dhe të mundohemi të marrim duanë e tyre.





Nëse ata janë të kënaqur me ne, kjo do t'i pëlqejë edhe Allahut, kështu edhe ata do të na bëjnë dua për mirësi. Nuk duhet të harrojmë të bëjmë dua për të rriturit e familjes.

Mund të bëjmë dua duke thënë: “O Allahu im i Lartësuar! Mundëso që unë të jem i mëshirshëm ndaj të vegjëlve, të jem i respektueshëm ndaj të rriturve. Mundëso që të jem i dobishëm ndaj të rriturve, që ata të jenë të kënaqur nga unë, edhe Ti ji i kënaqur nga unë”, ose mund të bëjmë dua për të afërmit me fjali të tilla të ngjashme.

U larguan nga kjo botë, por ende janë në zemrën tonë

Në botë, çdo sekondë lindin foshnja, por, po ashtu, çdo sekondë vdesin edhe njerëz. Ne e dimë që të vdekurit nuk zhduken, por fillojnë një jetë të re. Në fillim të asaj jete llogariten dhe peshohen sjelljet e të gjithëve, të mira ose jo, dhe jepet shpërblimi i tyre. Me siguri ka pasur nga të afërmit tanë që kanë ndërruar jetë. Edhe pse ndarja është e vështirë, ne mund ta qetësojmë zemrën tonë duke menduar se ata do të vijnë në jetë në një vend më të mirë. Përsëri mund të bëjmë dua për ta. Kështu tregojmë se ende vijon dashuria jonë për ta dhe se kërkojmë mirësinë e tyre.

O Zoti im i Lartësuar! Ti je Ai që na e ke lënë shpirtin amanet. Ti je edhe Ai që e merr atë kur i mbushet afati. Na mundëso që gjatë gjithë jetës të jetojmë si një njeri që e do.

Mund të bëjmë dua ndaj të vdekurve tanë duke thënë: “Allahu im! Mëshiroji të gjithë të dashurit dhe të afërmit e mi që tani nuk janë në jetë, ofroju atyre nga mirësitë e xhennetit”, ose me fjali të tilla të ngjashme.





Dua për nënat, baballarët dhe vëllezërit tanë

Nuk e di nëse keni qëndruar sadopak larg familjes suaj. Në kohët kur qëndrojmë larg dhe na merr malli shumë për ta, kuptojmë se sa të vyer janë për ne, edhe pse ndonjëherë e kemi pikëlluar familjen tonë gabimisht. Ja, pra, njeriu është kështu, nuk arrin të kuptojë sa duhet vlerën e atyre që zotëron, përpara se t'i humbasë. Ndërkohë, familja që kemi pranë përbëhet nga persona që janë të denjë për dashuri dhe respekt. Me nënën, babanë dhe vëllezërit tanë jemi si tullat e një muri. Dëmi që shkaktohet mbi një tullë ndikon tek i gjithë muri, por muri i fuqishëm nuk shembet nga dëmtimi i një tulle. Ata gëzohen dhe pikëllohen bashkë me ne. Të jemi një njeri që e kënaqim dhe e lumturojmë familjen tonë, t'u japim atyre vend në duatë tona, është një mirënjohje që duhet ta tregojmë. Njëra prej mirësive që duhet të tregojmë ndaj tyre është të bëjmë dua. Ata nuk duhet t'i harrojmë asnjëherë në duatë tona.



Mund të bëjmë dua duke thënë: “O Allahu im, Zoti i botëve! Mëshiroje nënën dhe babanë tim që më kanë rritur mua. Ashtu si ata më kanë edukuar mua, edhe Ti mbroji kështu ata. Si në botë, ashtu edhe në ahiret, mundësoji familjes sime mirësi dhe bukuri. Më mbro mua, nënën, babanë, vëllezërit dhe të gjithë nga të këqijat. Na mundëso që të jemi të mëshirshëm ndaj njëri-tjetrit”, ose në mënyra të tilla të ngjashme me këtë.

Nëse është shoku ynë, ne e duam shumë

Pas familjes sonë, personat pranë të cilëve e ndiejmë veten më të qetë, me të cilët ndajmë hallet dhe problemet, gëzimin dhe lumturinë, janë shokët e mi.

Duhet të bëjmë dua edhe për shokët tanë, të cilët i shohim pranë në ditë të mirë e të keqe dhe me të cilët ndajmë shumë gjëra të bukura.

Mund të bëjmë dua në formën: “Allahu im! Më mundëso



mua shoqëri me njerëz të mirë. Mundëso që të jem një person i dashur dhe i besueshëm kundrejt shokëve të mi. Mos krijo strehë për mllef, armiqësi dhe xhelozi ndërmjet nesh. Mundëso që të jemi të mëshirshëm ndaj njëri-tjetrit dhe ta duam njëri-tjetrin”, ose me fjali të tilla të ngjashme me këto.

Duaja që këndohet kur dalim nga shtëpia dhe kur futemi në shtëpi



Shtëpitë tona janë vende të posaçme, ku e ndiejmë veten në besim dhe të lumtur, ku jetojmë bashkë me familjen. Nëse dalim nga shtëpia duke shprehur fjalën bismil’lah dhe duke bërë dua, në këtë mënyrë jemi mbështetur tek Allahu kundrejt vështirësive të ndryshme. Nëse kërkojmë ndihmë nga Zoti ynë, kjo mundëson që ta ndiejmë veten mirë. Edhe kur hyjmë në shtëpi, nëse bëjmë dua, në çdo situatë, mund të kërkojmë mbrojtjen e tij.

Mund dhe duhet të bëjmë dua në formën: “O Allahu im, forca jote mjafton për çdo gjë! Mbështetem te mbrojtja jote nga të gjitha të këqijat, nga e keqja e njerëzve dashakeqës, nga aksidentet dhe fatkeqësitë. Deri kur të kthehem në shtëpi më mbro nga përballja me çdo të keqe, nga kryerja e një veprë të keqe dhe nga çdo lloj vështirësie që nuk e njoh. Allahu im, mundëso që të kthehem shëndoshë e mirë në shtëpi”, ose me fjali të tilla të ngjashme me këto.

Mund të bëjmë dua në formën: “Bismil’lahirrahmanirrahim, o Zoti im i Lartësuar! Hapi portat e mëshirës dhe të begatisë për ne, na dhuro shëndet, lumturi, gjallëri dhe harmoni, na e begato shtëpinë. Largoji nga shtëpia jonë vështirësitë, grindjet dhe problemet.

Fale të qetë e të paqshme familjen time”, ose me fjali të tilla të ngjashme me këto.



Shoku më i sinqertë në rrugën për në shkollë

Që nga dita kur ulemi në bankat e shkollës sonë, mësojmë shkrim, lexim, mbledhje, zbritje, shumëzim dhe pjesëtim, mësojmë paralelet dhe meridianët. Sa e sa gjëra mësojmë, ndërkohë që hyjmë edhe në një konkurrencë të shpejtë. Çdo ditë përballemi me dije të reja dhe kryejmë teste në mënyrë që të matet niveli i dijeve tona. Ndonjëherë provime me shkrim, ndonjëherë provime me gojë... Madje, këto provime sa vijnë e vështirësohen, organizohen provime ku marrin pjesë me mijëra persona. Pavarësisht të gjitha vështirësive, është bukur të shkojmë në shkollë. Për më tepër, nëse nisemi me dua kur shkojmë në shkollë, çdo hap yni dhe çdo orë që kalojmë atje, do të zbukurohet. Nuk duhet të harrojmë të bëjmë dua kur nisemi për në shkollë.

Mund të bëjmë dua në formën: “Allahu im! Më qartëso dhe më kthjelltëso mendjen, forcoje mentalitetin dhe konceptimin tim. Bëj që të jem i suksesshëm në mësim, shtojë dijen time. Mundëso që të mësoj lehtësisht dijet që do të më interesojnë në botë dhe në ahiret”, ose me fjali të tilla të ngjashme me to dhe mund t’i parashtrojmë atij kërkesat tona.

Suksesi më i madh

Suksesi është njëra prej ndjenjave që i fal gëzim zemrës sonë. Herë pas here, sukseset shpërblehen me çmime të mëdha. Ndonjëherë edhe një buzëqeshje bën që të përjetojmë atë sukses. Së pari, duhet të besojmë që me sukses kemi arritur më të mirën. Kurrë nuk duhet të lëmë pas dore mundin dhe përpjekjen në udhën e suksesit.





Edhe nëse rezultati është negativ, duhet të vazhdojmë të përpiqemi. Sepse sukcesi mundësohet duke vijuar punën, duke mos braktisur vullnetin dhe përpjekjen. Sado të mëdha të jenë shpërblimet që na presin, asnjëri prej tyre nuk mund të jetë më i madh se kënaqësia e Zotit tonë. Shpërblimet që jep Ai janë të vlefshme si në botë, ashtu edhe në ahiret.

Mund të bëjmë dua në formën: “Allahu im! Na mundëso të plotësojmë çdo përgjegjësi që marrim mbi vete. Na mundëso tejkalimin e pengesave që shfaqen në rrugën, na mundëso që të jemi në përpjekje të vazhdueshme. Mos e privo mëshirën dhe dhembshurinë tënde nga unë dhe gjithmonë më mundëso ndihmën tënde. Më mbro nga mburrja, mendjemadhësia dhe nga pëlqimi i vetes”, ose në forma të tilla të ngjashme me këto.

Duaja që këndohet për lehtësim

Nganjëherë, vështirësitë na bëjnë më të fuqishëm. Sepse kur u rezistojmë atyre dhe kur mundohemi të përballemi me ta, në këtë mënyrë zhvillojmë dhe formojmë veten. Mësojmë metoda të reja dhe fitojmë rezistencë. Mirëpo nuk duam që në jetën e përditshme vështirësitë të presin udhën tonë. Përsëri duhet të bëjmë dua që të mos largohemi nga rrugët e lehta për zgjidhjen e punëve, të përballemi me vështirësitë në punën tonë dhe që të mos na pakësohet munda e përpjekja. Për lehtësimin e punëve tona mund të bëjmë dua kështu:

“Rabbi jessir ue la tuassir, Rabbi temmim bilhajr.” “Zoti im! Lehtësoji punët tona, mos i vështirëso ato. Prijë drejt hairit kësaj pune.”

Duaja në udhëtim

Herë pas here nisemi për udhëtime të shkurtra, e herë të tjera për udhëtime më të gjata.



Në ndonjë rast, këto udhëtime zgjasin dy orë, në raste të tjera, disa ditë. Sado e madhe qoftë distanca mes vendit nga ku jemi ndarë dhe vendit ku do të shkojmë, të qenit në udhëtim ka disa vështirësi të posaçme. Pa dyshim që mund të kërkojmë ndihmë nga Zoti ynë për largimin e këtyre vështirësive duke bërë dua. Kështu, çdo gjë që nuk e kemi marrë me vete, e kemi dorëzuar në duar të sigurta.

I larti i të lartëve, Zoti im! Kërkoj ndihmë nga Ti, të të besoj Ty, lehtësoje udhëtimin tim, më mbro nga aksidentet dhe vështirësitë, më mundëso mirësi dhe bukuri. Jepi qetësi e gjallëri zemrës sime, lehtësoje punën time.

O Zoti im! Vetën time, fenë time, familjen, të afërmit dhe çdo gjë që zotëroj, ta lë Ty amanet. Na mbro ne nga çdo lloj e keqeje dhe nga gjëra të pikëlluara.

Mund të bëjmë dua ndaj Zotit tonë në formën: “Zoti im i bukur! Na prij në besim te vendi ku do të shkoj”, ose me fjali të tilla të ngjashme me to.



Hëngrëm dhe pimë, falënderimet qofshin për Krijuesin tonë

Siç e dini, në çdo vend të botës ka njerëz të uritur. Disa fëmijë ndërrojnë jetë para se të ecin, ngaqë nuk kanë gjetur ushqim për të ngrënë. Baballarët tanë punojnë që të përballojnë nevojat tona, nënat punojnë për mirëmbajtjen e rregullit dhe të harmonisë në shtëpi, duke kaluar orë të tëra në kuzhinë për të gatuar disa lloje ushqimesh. Por, ka edhe fëmijë që nuk e pëlqejnë ushqimin. Në fakt, ju e dini me sa shumë vështirësi gatohen, përgatiten dhe vijnë në sofrën tonë ato ushqime. Prandaj edhe duhet të fillojmë të shprehim bismil’lah kur nisim të ushqehemi. Pasi jemi ushqyer, duhet të falënderojmë Allahun duke thënë elhamdulillah dhe duhet të bëjmë dua.



Duhet të përpiqemi ta shndërrojmë në shprehi, që pas ushqimit të bëjmë dua në formën: “O Krijuesi im, që na ushqen dhe na fal jetë! Të falënderojmë për mirësitë që na dhuron, në mundëso jetë të mbarë dhe dhunti të lejuara. Na dhuro shëndet dhe harmoni”, ose në mënyrë të tilla të ngjashme me këtë.

Ndërkohë që lutemi për begati

Çdo gjë që mendojmë se është e pamjaftueshme, lutemi të begatohet. Begatia është një shtim misterioz. Begati do të thotë teprim i ushqimit, i cili mendonim se nuk do të mjaftonte, është zgjatja e kohës dhe të qenit e mjaftueshme për ne. Nëse në jetën tonë do të privohemi nga begatia, nuk do të kuptojmë gjë as nga ushqimi që hamë. Bëjmë dua që jeta jonë të begatohet, të mos pakësohet begatia nga punët që bëjmë dhe të fitojnë vlerë.

Mund të bëjmë dua në formën: “Allahu im! Forca është në dorën Tënde. Ti bëje të shumtë atë që është e paktë për ne. Begatoje atë që kemi në dorë. Begatoje ushqimin dhe veshjen tonë. Mos e largo begatinë nga jeta jonë, nga dashuria, shtëpitë dhe nga softrat tona”, ose të hapim duart drejt Zotit tonë apo të bëjmë dua nga brenda.

Dua kundrejt aksidenteve dhe fatkeqësive

Për arsye që nuk mund t'i kontrollojmë, mund të na ndodhin aksidente dhe të papritura të ndryshme. Këto aksidente dhe fatkeqësi mund të jenë aq të mëdha, sa të mos i tejkalojmë dot. Duhet të marrim çdo masë të nevojshme, materiale dhe shpirtërore, në mënyrë që të mos na ndodhin aksidente dhe fatkeqësi. Ndër masat kryesore është duaja e drejtuar ndaj Zotit dhe shprehja e dëshirës që të na mbrojë nga çdo lloj aksidentesh e fatkeqësish.



Duhet t'i drejtojmë dua Allahut duke thënë: “Allahu im! Ti je zotërues i çdo gjëje në qiej dhe në tokë. Mbështetemi tek Ti nga fatkeqësi si tërmeti, përmbytja, stuhia, zjarri dhe aksidentet rrugore, na mbro ne! Mundëso që, nëse na ndodh ndonjë aksident, të shpëtojmë me dëmin më të paktë nga ajo”, ose me fjali të tilla të ngjashme me to dhe duhet të mbështetemi tek Ai.

Edhe nëse pendohemi, kemi diçka që mund të bëjmë



Çdo njeri mund të gabojë. Për shembull, mund të kemi mërzhitur të tjerët me sjellje të gabuara. Në raste të tilla, duhet të kërkojmë falje nga bashkëbiseduesi ynë. Përveç kësaj, duhet t'i japim fjalën vetes që nuk do ta përsërisim më. Fjala më e bukur është fjala e përzemërt dhe e sinqertë që i japim Zotit. Kështu mund t'i shprehim pendimet tona si dua.

Mund të lutemi ndaj Krijuesit tonë dhe të përgjrohemi duke bërë dua: “Allahu im! Bëra gabim, por tani u pendova, më fal mua, më mbro nga mendimet dhe sjelljet e këqija që më dëmtojnë mua dhe njerëzit. Më mundëso që të jem një njeri i mirë, i dobishëm, i dashur dhe i drejtë.”

Dhurata më e bukur për të zotin e shtëpisë

Çfarë ju pëlqen më shumë kur shkonit mysafir? Gatimet e ndryshme, shokët e rinj, apo sjellja me tolerancë e nënës ndaj jush? Ndoshta ka edhe diçka tjetër që ju pëlqen. Sidoqoftë, ne ndiejmë kënaqësi kur shkojmë mysafir dhe kur na mirëpresin. Për këtë falënderojmë të zotin e shtëpisë. Pavarësisht nëse i zoti i shtëpisë është ose jo në dijeni, ne mund ta falënderojmë atë me dua. Sepse duaja është falënderimi më i bukur.

Mund të bëjmë dua duke thënë: “Allahu im! Ashtu si i zoti i shtëpisë na ofroi ne, edhe Ti ofroji atij, dhuroji mirësi të shumta, shtoja riskun dhe mëshiroje atë. Kur dikush të vijë mysafir te ne, mundëso që të sillemi në formën më të bukur ndaj tij”, ose me fjali të tilla të ngjashme me këto.

Duatë i shtojnë gëzim gëzimit

Gjatë jetës, ashtu siç kemi çaste kur jemi të sëmurë ose të mërzhitur, ka edhe çaste kur jemi të gëzuar dhe të lumtur. Dua nuk do të thotë të kërkosh ndihmë nga Allahu vetëm në kohë të vështira. Përkundrazi, duhet ta përmendim Zotin në çdo kohë, edhe në çastet tona të lumtura. Pra, nuk duhet të harrojmë të bëjmë dua në kohë të gëzuara dhe të lumtura.


Mund të bëjmë dua në formën: “O Zoti im i lartë! Fale të përhershëm gëzimin, qetësinë dhe lumturinë time. Më bëj mua nga njerëzit që nuk të harrojnë Ty në gëzim e në lumturi dhe që nuk e teprojnë. Më duaj mua, bëj të mundur që të jem një njeri që do dhe që duhet, mos e shndërro gëzimin tim në hidhërim.”



Dua që të falin qetësi e prehje

O Krijuesi im i lartë! Falënderime pafund për çdo mirësi që më ke dhuruar. Salat dhe selam qofshin për Pejgamberin tënd të dashur.

Allahu im! Mundëso që të jem një njeri që të do Ty, që do Pejgamberin, që të bindet ty dhe Pejgamberit. Mbushi të gjitha ditët e mia me mirësi dhe me bukuri. Kërkoj nga Ti çdo lloj hairi, bukurie dhe mirësie, në botë e në ahiret; mbështetem tek Ti nga çdo lloj e keqeje.



“O Allahu im, Zoti i të gjitha botëve! Të adhuroj vetëm Ty, kërkoj ndihmë vetëm nga Ti. Fuqia jote mjafton për çdo gjë. Ti di çdo gjë që unë kam bërë të ditur dhe që kam fshehur. Më mëshiro dhe mbushe zemrën time me mëshirë, dhembshuri dhe dashuri. Mbështetem tek Ti nga dembelizmi, munda i kotë, harxhimi i kohës në mënyrë të pavend, puna pa rregull dhe program, nga mungesa e suksesit, nga dëmet që mund t’u shkaktoj njerëzve, atyre që kemi përreth dhe vetes.

Allahu im! Forcoje besimin tim, shtoji veprat e mia dhe zbukuroje moralin tim. Mbështetem tek Ti nga duaaja që nuk pranohet. Kërkoj nga Ti ato që ka kërkuar Pejgamberi ynë i dashur, mbështetem tek Ti njësoj siç është mbështetur ai.

Allahu im! Mbështetem tek Ti nga veprat që mund të kryej prej pakujdesisë, mbështetem tek Ti nga pësimi i padrejtësisë, nga kryerja e padrejtësisë. Bëje të hairit rezultatit e punëve të mia, mundëso që t’i vijojmë gjithmonë ato me hair. Më bëj mua njeri të dobishëm për familjen, shtetin dhe njerëzimin. Na gëzo ne me mirësitë më të bukura në botë dhe në ahiret.

Allahu im! Mbroje zemrën time nga çdo lloj e keqeje. Mos lejo që në zemrën time të vendosen frikërat, vështirësitë dhe veset që nuk i duam. Mos më bëj mua nga njerëzit që mendojnë vetëm për vete, që zmadhojnë problemet e tyre dhe ndërpresin marrëdhënien me njerëzit e tjerë, mos më bëj mua nga njerëzit egoistë dhe mendjemëdhenj. Mundëso që të jem ndër robërit bujarë.

Allahu im! Ti je falës, e do faljen. Fali gjynahet, mangësitë e mia dhe gjynahet e të gjithë besimtarëve.

Krijuesi im i lartësuar! Më bëj mua nga robërit që do. Lehtësoji punët e mia, zbukuroje jetën time. Më bëj mua nga ata, pas të cilëve flitet për mirësi dhe bukuri. Çdo gjendje që nuk e do, largoje nga unë. Më bëj mua nga ata që me jetën, sjelljet dhe me fjalët të tregojnë ty dhe Islamit në formën më të bukur.

Allahu im! Lehtësoji punët e mia. Emrat e tu janë emrat më të bukur dhe të përgjerohem Ty me ato emra. Fal begati në jetën dhe në punët e mia. Mundëso që të jem në dijeni të mirësive që zotëroj, të shpreh falënderim për to dhe të mos i harxhoj më kot, të mos i shpërdoroj pa kriter.

Allahu im! Mos bëj që të jem një ndër ata që humbet në punë të padobishme dhe në dëfrime të kota, nga ata që harrojnë adhurimet e tyre. Bëj të mundur që gjuha ime të flasë gjithmonë drejt. Më mbro nga çdo lloj ngatërrese dhe fatkeqësie, aksidenti dhe të papriture.



